

# Përkrahja e kompetencës ndërkulturore



Materiale për mësimin në gjuhën e prejdardhjes

**Nxitje didaktike**



# Përkrahja e kompetencave ndërkulturore

Zeliha Aktaş

në bashkëpunim me  
Hüsniye Göktaş, Rolf Gollob,  
Basil Schader, Wiltrud Weidinger

Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

**Nxitje didaktike**

**4**

---

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» (MGJP; në Zvicër GJKA (Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut); Nxitje didaktike 4.

Botuar nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike.



---

Udhëheqës i projektit: Basil Schader

---

Autore: Zeliha Aktaş, në bashkëpunim me Rolf Gollob-in, Basil Schader-in dhe Wiltrud Weidinger-in (të gjithë nga SHLP [PH Zürich]).

---

Redaktimi nga ana e MGJP: Hüsniye Göktaş, Cyrih

---

Mësuesit/et provues/e: Nexhat Maloku, Cyrih (GJKA shqip)  
Hüsniye Göktaş, Cyrih (GJKA turqisht)  
Dragana Dimitrijević, Cyrih (GJKA serbisht)  
Elisa Aeschmann-Ferreira dhe Raquel Rocha (GJKA portugalisht)  
Hazir Mehmeti, Vjenë  
Rifat Hamiti, Dyseldorf

---

Ilustrimet, koncepti i përgjithshëm pamor dhe realizimi: Barbara Müller, Erlenbach

---

Përkthimi: Nexhat Maloku, M.A.

---

Shtypi: Shtypshkronja Printing Press, Prishtina/Kosova

---

Ky publikim u mundësua me përkrahjen e Entit Federal për Kulturë (BAK)



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Eidgenössisches Departement des Innern EDI  
Bundesamt für Kultur BAK

---

Ky projekt u financua pjesërisht me përkrahje të Komisionit Evropian. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij publikimi e bart vetë hartuesi; Komisioni nuk merr përgjegjësinë për përdorimin e mëtejshëm të të dhënave të përmbajtjes.



Lifelong Learning Programme

---

Numri ISBN i botimit përkatës gjermanisht:

ISBN 978-3-280-04121-5

---

# Pasqyra e përmbajtjes

<b>Parafjalë për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»</b>	<b>7</b>
---	----------

---

## Hyrje

<b>1</b> Përkrahja e kompetencave ndërkulturore në MGJP: arsyetimi dhe rëndësia	<b>8</b>
<b>2</b> Qëllimi dhe ndërtimi i kësaj broshure	<b>8</b>
<b>3</b> Orientimi në fushën e kompetencave në MGJP	<b>9</b>
<b>4</b> Koncepti i mjedisit jetësor si bazë e rëndësishme	<b>9</b>

---

## **1** Njësia 1: Kultura dhe identiteti – të njëjtë, e megjithatë të ndryshëm! (Zeliha Aktaş)

<b>1.1</b> Ky jam unë	<b>14</b>
<b>1.2</b> Pamja e brendshme – pamja e jashtme	<b>15</b>
<b>1.3</b> Unë dhe të tjerët	<b>18</b>
<b>1.4</b> Më lejoni të fluturoj	<b>19</b>
<b>1.5</b> I pranuar – i përjashtuar	<b>21</b>
<b>1.6</b> Molekula personale e identitetit	<b>22</b>
<b>1.7</b> Bashkërisht jemi më të fortë	<b>23</b>

---

## **2** Njësia 2: Historitë e migrimit – Bota në klasën tonë (Zeliha Aktaş)

<b>2.1</b> Të shpërndarë nga era	<b>28</b>
<b>2.2</b> Historitë e migrimit në klasën time	<b>29</b>
<b>2.3</b> Biografia ime e migrimit si burim force	<b>30</b>
<b>2.4</b> Atdhetë e mi – tregime autobiografike	<b>31</b>
<b>2.5</b> Më herët – sot – nesër	<b>32</b>
<b>2.6</b> Unë shkruaj historinë!	<b>34</b>
<b>2.7</b> Tri ide për ditët e projektit	<b>35</b>

---

---

### **3 Njësia 3: Gjuha jonë - Ne flasim më shumë se një gjuhë!** (Basil Schader)

<b>3.1</b>	Tiparet e gjuhëve	40
<b>3.2</b>	Projektet dy- ose shumëgjuhësore me shkrim	41
<b>3.3</b>	Tema biografike gjuhësore	42
<b>3.4</b>	Përdorimi i mediave elektronike në gjuhë të ndryshme	43
<b>3.5</b>	Dialektet në gjuhën tonë dhe në gjuhët e tjera	44
<b>3.6</b>	Korrespondenca për çështjet ndërkulturore	45
<b>3.7</b>	Përdorimi i gjuhës: i ndryshëm sipas kontekstit!	46

### **4 Njësia 4: Komunikimi ndërkulturor – bashkërisht t'ia dalim mbanë** (Zeliha Aktaş)

<b>4.1</b>	Diçka nuk është në rregull këtu	50
<b>4.2</b>	Me gjuhë të tregohet rruga	52
<b>4.3</b>	Të dëgjuarit aktiv	53
<b>4.4</b>	Për vizitë	55
<b>4.5</b>	Si sillem unë në situata kritike?	57
<b>4.6</b>	Atribuimet	59
<b>4.7</b>	Çka e pengon komunikimin	61

### **5 Njësia 5: Konfliktet – bashkërisht të kërkoen zgjidhjet** (Wiltrud Weidinger)

<b>5.1</b>	Gjithçka në rregull! Vërtet?	66
<b>5.2</b>	Jo-ja ime	67
<b>5.3</b>	Arsye të mira për veprime të këqija?	68
<b>5.4</b>	Kështu e bëjmë ne këtë!	68
<b>5.5</b>	Të ruhet gjakftohtësia ose i mençuri lëshon/largohet	69

---

<b>5.6</b>	Termometri im i konfliktit	70
<b>5.7</b>	Në 6 hapa të zgjidhet problemi/konfliktet e bashkëmoshatarëve	71

---

## **6** Njësia 6: Demokracia dhe të drejtat e fëmijëve – ne përzihemi! (Rolf Gollob)

<b>6.1</b>	Një tufë lulesh	76
<b>6.2</b>	Të gjithë të ndryshëm – të gjithë të njëjtë	77
<b>6.3</b>	Nëse do të isha një magjistar/magjistare	78
<b>6.4</b>	Udhëtimi i balonës	79
<b>6.5</b>	Të drejtat, përgjegjësitë dhe rregullat në klasë	81
<b>6.6</b>	Posteri i të Drejtave të Njeriut	82
<b>6.7</b>	Pakicat	83

---

### **Përmbledhje e sugjerimeve për mësimdhënie sipas fushave të kompetencave** 85

---

### **Literatura e përdorur** 86

---

---

## Sqarimet, shkurtesat

Gjuha e parë: Edhe gjuhë amtare – ose familjare: gjuha të cilën një fëmijë e ka mësuar dhe folur si gjuhë të parë në shtëpi. Mjaft fëmijë kanë dy gjuhë.

Gjuha shkollore: Gjuha e cila flitet në shkollën e vendit emigrues. Gjithashtu mund të vijë edhe dialekti lokal si gjuhë e rrethit

Shkurtesat: N = Nxënës, nxënëse  
M = Mësues, mësuese

### Legjenda

për të dhënat për formën sociale, klasën dhe kohën e nevojshme tek propozimet mësimore:



PI = Punë individuale



PP = Punë me partner



GV = Grup i vogël



TK = Tërë klasa

kl. 1–9

E përshtatshme për klasat ... deri ... (p.sh. kl 2–4). Kujdes: Kjo renditje mund të ndryshojë sipas parakushtit të nxënësit,-es veç e veç.

10–15 min.

Nevoja për kohë të përafërt, p.sh. 20 min. (e dhënë e përafërt, duhet të vendoset nga mësimpldhënësi sipas gjendjes së parakushteve të klasës).



# Parathënie për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

Mësimi në gjuhën amtare ose të prejardhjes (MGJP; në Zvicër GJKA, mësimi në gjuhën dhe kulturën e atdheut) luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin gjuhësor dhe të identitetit si dhe për përkujdesjen për shumëgjuhësinë, si një rekurs vetjak dhe shoqëror me shumë vlerë. Lidhur me këtë fakt, hulumtimet, linjat drejtuese, si edhe rekomandimet e Këshillit të Evropës R(82) 18 dhe R (98) 6, janë të qarta që prej shumë kohësh. Megjithatë ky mësim zhvillohet, në krahasim me mësimin e rregullt, ende në kushte të vështira. Kjo gjë ndodh për arsye të ndryshme:

- Mësimi në gjuhën e prejardhjes në shumë vende, përsa i përket aspektit financiar dhe institucional, qëndron në themele të dobëta. Pagesa e mësimdhënësve në Zvicër është pothuaj si kudo çështje e vendeve të prejardhjes madje edhe e prindërve.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është më së shumti i lidhur jo mirë me mësimin e rregullt. Kontaktet dhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e klasave të rregullta, shpesh zhvillohen shumë dobët.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes zhvillohet në më të shumtën vetëm dy orë në javë, gjë që e vështirëson punën në vazhdimësi.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është, në të shumtën, vullnetarisht, detyrimi për nxënësit nuk është shumë i fortë.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes, si rregull, zhvillohet si mësim në shumë klasa, në të cilin marrin pjesë njëkohësisht nxënës që nga klasa e parë e deri në klasën e nëntë. Kjo kërkon nga mësimdhënësit aftësi të lartë didaktike si edhe aftësi për të diferencuar nxënësit në klasë.
- Heterogjeniteti i bashkësisë së nxënësve në mësimin e gjuhës së prejardhjes është veçanërisht shumë i lartë edhe në raport me kompetencat gjuhësore të nxënësve, ndërkohë kur disa sjellin nga shtëpia njohuri të mira në variantet dialektore ose të standardit të gjuhës së parë, të tjerë e flasin këtë vetëm në dialekt. Shumica që jeton tashmë në gjeneratën e dytë apo të tretë në vendin e ri të emigrimit, gjuha e atij vendi (p.sh. gjermanishtja) është bërë gjuhë e fortë, derisa gjuhën e parë e zotërojnë vetëm në variantin dialektor, dhe atë vetëm gojarisht dhe me një leksik të kufizuar rreth temave familjare.

- Mësuesit e gjuhës së prejardhjes parimisht kanë marrë në vendet e tyre të prejardhjes një arsimim të mirë bazë, por nuk janë të përgatitur për realitetin dhe specifikat e mësimin në shkollat me shumë klasa në emigrim. Mundësitë e kualifikimit në vendet e emigrimit zhvillohen në masë ende të pamjaftueshme.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» i përkrah mësimdhënësit e këtij mësimi në detyrën e tyre të rëndësishme e me kërkesa të larta, e me këtë dëshiron të japë ndihmesë për një cilësi maksimale të tij. Nga njëra anë është me rëndësi dhënia e principeve dhe e arsyeve të pedagogjisë dhe didaktikës në vendet emigruese perëndimore dhe evropianoveriore, (krahaso fletoren «Bazat dhe sfondet») nga ana tjetër dhënia e shtysave dhe modeleve mësimore praktike e konkrete. Përparësi përbën këtu përkrahja e kompetencave gjuhësore. Tek shtysat didaktike në mënyrë të vetëdijshme përdoren principet dhe metodat, të cilat për nxënësit janë të njohura nga mësimi i rregullt dhe tekstet mësimore përkatëse. Për këtë do të duhej që mësimi në gjuhën e prejardhjes dhe mësimi i rregullt, mundësisht t'i afrohen njëri-tjetrit në kuptim të një koherence të madhe. Përmes faktit që mësimdhënësit e mësimin në gjuhën e prejardhjes, njohin edhe elemente didaktike dhe metoda konkrete, që janë aktuale tek nxënësit në mësimin e rregullt, ata bëjnë njëkohësisht një pjesë kualifikimi dhe shpresojmë për një forcim të formimit të tyre si partnerë të barasvlershëm në procesin arsimor me nxënësit e rritur në sfondin dygjuhësor respektivisht dykulturor.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet nga Qendra «International Projects in Education (IPE)» dhe Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih. Ajo lindi mes një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet personave profesionistë zviceranë, atyre evropianoperëndimor në njërin anë, dhe të ekspertëve e mësimdhënësve të mësimin në gjuhën e prejardhjes, nga ana tjetër. Me këtë do të sigurohet se dhënia e informacioneve dhe e shtysave u përgjigjet gjendjes faktike, nevojave dhe mundësive të mësimin në gjuhën e prejardhjes dhe se janë funksionale e praktike për këtë mësim.

# Hyrje

## 1. Përkrahja e aftësive ndërkulturore në MGJP: arsyetimi dhe rëndësia

Fëmijët dhe të rinjtë rriten në vendet e emigracionit (dhe edhe në shumë vende të tjera) në kontekste kulturore dhe gjuhësore shumë heterogjene. Kjo larmi është veçanërisht e dukshme në kontekstin e jetës në shkollë, ku zor se ka ndonjë klasë në të cilën nuk janë të përfaqësuara disa gjuhë dhe kultura dhe ku përqindja e nxënësve/eve me sfond migrimi nuk është deri në 30, 40, 50 ose më shumë për qind. Një përjashtim në kontekstin institucional të shkollës përfaqësojnë klasat e mësimi të gjuhës së prejardhjes (GJKP). Megjithatë edhe këtu ka dallime dialektore (krahinore) dhe kombëtare (p.sh. arabishtfolësit nga vende të ndryshme arabe), por megjithatë ne mund të flasim për një MGJP në arabisht, turqisht, shqip etj.

Një detyrë qendrore e shkollës është të përgatitë fëmijët dhe të rinjtë për jetën në shoqëri. Në rastin tonë, kjo do të thotë: për jetën në një shoqëri multikulturore, shumëgjuhësore. Kjo detyrë vlen për klasën e rregullt, si dhe për MGJP. Në mësimin e rregullt shkollor, në përputhje me planin mësimor, jepen më tepër përmbajtje dhe tema që lidhen me vendin e emigracionit, kurse në MGJP më tepër ato që a) kanë të bëjnë me vendin e prejardhjes, me kulturën dhe me gjuhën e tij, dhe b) në marrëdhënie me jetën në vendin e emigrimit.

Të dy palët, megjithatë, duhet ta bëjnë mirë punën e tyre, të kontribuojnë në mënyrë aktive në ndërtimin e një sërë aftësish, të cilat janë thelbësore për jetën multikulturore në shoqëritë shumëgjuhëshe. Këto përfshijnë, për shembull, aftësitë e menaxhimit të konfliktit dhe tolerancën, interesin dhe pranimin (dhe jo refuzimin) ndaj kulturave të tjera dhe mënyrave të jetës dhe gatishmërinë për t'i rishqyrtuar vlerat e veta, normat dhe rolet.

Për fëmijët dhe të rinjtë nga familjet emigrante është edhe një tjetër aspekt i rëndësishëm i kompetencës ndërkulturore: orientimi nëpërmjet kulturës së prejardhjes dhe asaj të vendit pritës. Për arsye të tensionit mes kulturave dhe (pjesërisht edhe) të normave dhe vlerave të ndryshme mund të rezultojnë konflikte të mëdha dhe penguese për zhvillimin e kësaj kompetence. Mësuesit/et e MGJP në këtë aspekt mund të japin ndihmesa shumë të vlefshme ngase ata, me këto dy kontekste kulturore, janë shpesh më të mirë se mësimdhënësit e klasëve të rregullta. Se si do të duken këto ndihmesa të MGJP në gjashtë tema të ndryshme (shih më poshtë) tregojnë sugjerimet mësimore në këtë broshurë. Nëse zbatimi i tyre, përshtatja dhe zgjerimi çojnë në leksione mbresëlënëse, stimuluese dhe udhëzuese, atëherë qëllimi i broshurës është mbërritur.

## 2. Qëllimi dhe ndërtimi i kësaj broshure

Kjo broshurë i përkrah nxënësit/et dhe mësimdhënësit e MGJP në bazë të temave të zgjedhura për të ndërtuar aftësitë ndërkulturore. Këto duhet t'i aftësojnë fëmijët dhe të rinjtë që të jenë në gjendje të ballafaqohen me kushtet e tyre të mjedisit jetësor dhe me kontekstin social. Forcimi i identitetit të tyre multikulturor dhe shumëgjuhësor mund t'u shërbejë si një pasuri e vlefshme, kur vjen puna për të komunikuar në mënyrë adekuate, në një shoqëri shpesh kontradiktore dhe të pasigurt, për t'i nyjetuar pritjet dhe të dinë të merren me situatat konfliktuale.

Broshura përfshin gjashtë njësi tematike, të cilat janë ndërtuar në mënyrë identike. Secila fillon me një hyrje të shkurtër dhe përfshin shtatë propozime të veçanta mësimore, të cilat lidhen me fusha të ndryshme të kompetencave (shih më poshtë; krahaso vështrimin në fund të broshurës). Propozimet mësimore janë të përshtatura për vite të caktuara shkollore, përkatësisht nivele të caktuara, të cilat, megjithatë, pothuajse të gjitha, lejojnë të realizohen, me përshtatje përkatëse, në çdo nivel, të sipërm apo të poshtëm.

Tek përzgjedhja e temave për të gjashtë njësitë, kriter-çelës ishte përqëndrimi në rrethanat aktuale të mjedisit dhe jetës së fëmijëve dhe të rinjve. Për t'i mbështetur nxënësit/et në mënyrë optimale dhe autentike në fushën e tyre të mundësive vepruese dhe në vetefikasitetin e tyre, sugjerimet mësimore u hartuan në atë mënyrë që ata të tematizojnë, si potencial për konflikt ashtu edhe mundësitë dhe burimet, dhe të përkrahin të mësuarit ndërkulturor si detyrë e tërthortë e të mësuarit në të gjitha nivelet. Gjithmonë të bashkërenduara dhe shumë të dëshirueshme janë bashkëpunimet me mësimin e rregullt apo me grupet e tjera të GJKP.

Të gjashtë njësitë paraqiten (në kllapa janë fushat kryesore të përkrahjes) si më poshtë:

- 1 Kultura dhe identiteti:** të njëjtë, por, megjithatë, të ndryshëm! (*Përkrahja e zhvillimit të identitetit*).
- 2 Historitë e migrimit:** Bota në klasën tonë (*të mësuarit biografik*).
- 3 Gjuhët tona:** Ne flasim më shumë se një gjuhë! (*Vetëdijësi për shumëgjuhësinë e mjedisit jetësor si një burim*).
- 4 Komunikimi ndërkulturor** – bashkërisht t'ia dalim mbanë (*aftësia për komunikim*).

---

**5 Konfliktet:** bashkërisht të kërkoen zgjidhjet (njohja e konfliktit dhe zotësia e zgjidhjes së tij).

---

**6 Demokracia dhe të drejtat e fëmijëve:** ne do të marrim pjesë në to! (*Kuptimi për drejtësinë, nocioni i demokracisë*).

---

Shumë nga këto tema u referohen përvojave shumë personale, përjetimeve dhe pikëpamjeve të nxënësit/es. Praktikimi i tyre në klasë kërkon nga mësuesi/ja delikatesë, maturi dhe një klimë klase të karakterizuar nga besimi dhe pranimiti. Pa këto parakushte të rëndësishme, rreziku është i madh që nxënësit/et nuk do të jenë të hapur për t'i trajtuar këto tema dhe qëllimet e paraqitura më lart nuk do të arrihen ose do të arrihen vetëm pjesërisht.

---

### 3. Orientimi në fushën e kompetencave në MGJP

Orientimi në fushën kompetencave, si një parim i rëndësishëm i pedagogjisë aktuale, trajtohet me hollësi në kapitujt 2, 5 dhe 9 të doracakut „Bazat dhe arsyet“. Janë tri kompetencat kryesore të një rëndësie themelore për temën e kësaj broshure:

---

- a) *Kompetenca e perceptimit*, e zgjeruar në kompetencën e pranimit: këtu bëhet fjalë për zhvillimin kognitiv të aftësisë ndijore-emocionale, për perceptimin e botës së jashtme dhe botës së brendshme me të gjitha shqisat, për zhvillimin e përfytyrimeve të brendshme për ta perceptuar veten si pjesë e proceseve të komunikimit. Nxënësit merren seriozisht dhe pranohen me botët e tyre emocionale dhe format e përvetësimit.

---

  - b) Tek *kompetenca e reflektimit* bëhet fjalë për zhvillimin e aftësisë kognitive, që duke përdorur gjuhën (përkatesisht konceptet abstrakte) të krijohen lidhje sa më të mëdha e të ndërsjella, të trajtohen dhe të reflektohen.

---

  - c) Tek *kompetenca (komunikuese) e të vepruarit* bëhet fjalë që të perceptuarit dhe të reflektuarit, nëpërmjet veprimit komunikues, të gjejë shprehje në botën personale jetësore. Nëpërmjet kësaj i mundësohet individit të ndikojë në mjedisin e tij jetësor dhe të zhvillojë forma të reja të shprehjes dhe perspektiva të reja të veprimit.
- 

Sipas Holzbrecher (1999/2009; shih bibliografinë) tek kompetenca ndërkulturore bëhet fjalë për ndërlidhjen e fushës së subjektit me botën jetësore dhe me fushën shoqërore, në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë të mund të fitojnë përvojën e vetefikasitetit. Kjo kategori e katërt mundëson për të zhvilluar modele të reja përceptimi, reflektimi dhe veprimi.

---

### 4. Koncepti i mjedisit jetësor si bazë e rëndësishme

Se sa e rëndësishme është që pedagogjia dhe mësimi në shkollë t'i përshtaten botës reale jetësore të nxënësve/eve, është theksuar disa herë në doracakun „Bazat dhe arsyet“; krahaso sidomos kap. 5.4 dhe 2.3. Sigurisht, që orientimi nga bota jetësore luan një rol qendror edhe në pikëpamje të ndërkulturës dhe kompetencave ndërkulturore. Kjo, vlen edhe për aspektet gjuhësore të shoqërisë multikulturore: shumëgjuhësia e bota jetësore, jeta në, me dhe mes gjuhëve të ndryshme – është një realitet i gjallë, i cili duhet të diskutohet dhe të vlerësohet (krahaso posaçërisht për këtë qëllim, njësinë 3 «Gjuhët tona»).

Fëmija i MGJP si subjekt i mjedisit të tij të jetesës është gjithmonë edhe anëtar i shoqërisë. Si i tillë, ai lëviz në fushën e subjektit, mjedisit të jetesës dhe të shoqërisë. Me këto fusha lidhen edhe ndërveprimet e situatave të shumta ndërkulturore dhe ndërvepruese (interaktive). Këto kërkojnë të mësuarit ndërkulturore, ballafaqimin me proceset e identitetit dhe kushteve shoqërore. Në të njëjtën kohë ato mundësojnë që njerëzit ta përjetojnë veten si subjekte vetëvepruese. Pjesa në vijim e sqaron më për së afërmi këtë parim të rëndësishëm.

#### Subjekti dhe orientimi në mjedisin jetësor

Fëmijët dhe të rinjtë lëvizin në kontekste të ndryshme: në familje, në shkollë filllore, në kohë të lirë, tek të afërmit, tek fqinjët, me bashkëmoshatarët (në rrethin shoqëror) etj. Secila nga këto kontekste sociale paraqet një botë të vogël, me vlerat dhe normat e veta; tërësia e tyre e përbën mjedisin jetësor të individit. Orientimi në mjedisin jetësor, si parim pedagogjik ka kuptimin e orientimit drejt fëmijës si subjekt të caktuar (këtu dhe tani), me paranjohuritë e tij, me qëndrimet e tij, me rolet e ndryshme dhe me botën e brendshme të tij.

Fëmijët duhet të ballafaqohen me identitetin e tyre dhe me përfytyrimin që kanë për veten dhe për të tjerët, në mënyrë që ta perceptojnë veten të aftë si subjekte vetëvepruese dhe të marrin përgjegjësi për veten e tyre dhe për organizimin e mjedisit të tyre të jetesës. Ata duhet të zhvillojnë ndjeshmërinë (sensibilitetin) për perceptimin e vetvetes dhe të tjerëve dhe të ballafaqohen, si me ngurrimet (rezistencat) e brendshme, ashtu dhe me kërkesat e jashtme.

Orientimi në mjedisin jetësor, gjithashtu, do të thotë se fëmijët dhe të rinjtë, si pjesëmarrës në mjedisin e tyre të drejtpërdrejtë, fitojnë përvoja të cilat lidhen edhe me rrethanat e tyre jetësore dhe të strukturuar në aspektin kohor, hapësinor dhe social. Në punën me nxënësit/et e MGJP duhet të llogariten së paku dy sfonde kulturore dhe etnike: të këtushmet dhe të atjeshmet. Të parat qëndrojnë në aspektin hapësinor, në rrethin aktual, në vendin mikpritës. Mjediset jetësore në vendin e origjinës qëndrojnë në një rreth potencial, sepse për nxënësit/et siguria qëndron edhe atje – p.sh. tek farefisi i atjeshëm, ku mund të fitojnë përvojat, të cilat mund t'i përdorin pastaj si burime.

Përveç përmasës hapësinore, koncepti i mjedisit jetësor ka edhe një përmasë kohore. Për t'i dalluar këtu janë a) perceptimet dhe përvojat subjektive, aktualisht të përjetuara dhe b) integrimi social në strukturat më të mëdha, historikisht të zhvilluara shoqërore. Mësimi i orientuar nga mjedisi jetësor bazohet në të dy përmasat dhe orientohet në parimin e të mësuarit biografik. Ai e merr seriozisht faktin se vetefikasiteti i përjetuar në kohën e tashme i hap perspektiva individit që edhe në të ardhmen të mbetet i aftë për të vepruar dhe për t'i realizuar synimet e tij të identitetit. Duke qenë se mjediset jetësore, në të njëjtën kohë, përfaqësojnë edhe zona të zhvilluara historikisht, ato gjithashtu përfshijnë edhe përvojat e lidhura me biografinë e migrimit, kompetencat dhe burimet. Kjo mund ta ndihmojë fëmijën në vetefikasitetin e tij, duke e bërë atë të ndërgjegjshëm se përvojat e tij të mëparshme janë një burim i rëndësishëm për të.

Përpos përmasës hapësinore dhe kohore në konceptin e mjedisit jetësor vjen në vend të tretë edhe përmasa sociale. Nëpërmjet kësaj përmase, fëmija përfshihet në një sistem ndërveprimi që, në çdo mjedis të jetës shoqërore, i mundëson atij për ta interpretuar realitetin dhe për t'u sjellë në mënyrë të përshtatshme në atë realitet. Në çdo mjedis social fëmija shfrytëzon pasuri të ndryshme të dijes, modele të ndryshme të interpretimit dhe shpesh edhe një gjuhë të veçantë, të cilat ai i vë në shfrytëzim në situatat konkrete dhe ndërvepruese. Për shembull, nxënësit/et turq të MGJP në Zvicër kanë, në këtë kuptim, jo thjesht një kulturë (gjoja homogjene) turke dhe zvicerane, por një kulturë familjare, një kulturë shkollore, një kulturë të veçantë turko-zvicerane të migrimit, kanë gjuhën dhe kulturën e bashkëmoshatarëve, një kulturë të kohës së lirë, një kulturë të ushqimit, një kulturë të muzikës etj. Vlerat dhe normat e ndryshme, të cilat vlejnë në këto mjedise sociale veç e veç, qëndrojnë pjesërisht në kundërtënie mes tyre dhe relativizohen. Shpesh, nga përplasje ndërmjet këtyre mjediseve të ndryshme jetësore dhe modeleve të veprimit dhe interpretimeve, krijohen edhe tensione. Shembull klasik janë konfliktet që lindin nga fakti se prindërit janë ende të orientuar fuqishëm drejt sistemit të vlerave të vendit të

prejardhjes, por fëmijët e tyre i përfaqësojnë normat që ata kanë mësuar nga shoku i tyre/shoqja e tyre në vendin e emigracionit.

MGJP këtu mund dhe duhet të luajë rol të rëndësishëm ndërmjetësues. Këtë mund ta bëjë duke u mbështetur në parimin e ndërkulturës dhe të mjediseve të ndryshme jetësore të nxënësve/eve, si dhe në orientimin e tyre, ta marrë seriozisht dhe ta tematizojë. Nëpërmjet kësaj, zhvillohen mundësi dhe perspektiva të reja veprimi dhe ky mësim mund t'i forcojë fëmijët dhe të rinjtë në identitetin dhe rolin e tyre si organizues të jetës së tyre.

**Njësia 1:**  
**Kultura dhe identiteti –**  
**të njëjtë e, megjithatë,**  
**të ndryshëm!**



Jo vetëm shkolla fillore, por edhe mësimi në gjuhën e prejdardhjes (MGJP) synon të mbështesë të gjithë nxënësit/et në zhvillimin e identitetit të tyre. Zhvillimi i identitetit personal dhe ballafaqimi me të kushtëzon një dialog plot emocion gjatë tërë jetës së individit me veten dhe mjedisin.

Në një kontekst shumëkulturore dhe shumëgjuhësor, para nxënësve/eve shtrohen kërkesa të rrepta, kur është fjala për të pohuar identitetin e tyre dhe për të përjetuar veten si vetëveprues, në kuadrin e pluralizmit të mjediseve jetësore, të situatave ekonomiko-shoqërore e të pabarabarta dhe të vlerave të ndryshme.

Nxënësit/et e MGJP nuk mund t'i shpëtojnë, as ballafaqimit me statusin e tyre minoritar dhe me prejdardhjen e tyre kulturore, por as nuk mund t'i mohojnë veçantitë e tyre kulturore. Në proceset e vazhdueshme të marrëveshjeve midis tyre dhe mjedisit të tyre, ata janë, në njërin anë, të varur nga pranimi në shoqëri dhe, nga ana tjetër, janë të varur nga hapësirat dhe vendet e sigurisë dhe të identifikimit, ku i tematizojnë përvojat e të qenit të përjashtuar dhe ku mund të sigurojnë identitetin e tyre.

MGJP mund t'u ndihmojë nxënësve/eve për të pasqyruar përvojat e tyre të ndryshme dhe për t'i përpunuar ato. Në këtë mënyrë, ky mësim, mund të luajë rol të rëndësishëm, kur është fjala për zhvillimin e çiltërsisë dhe të tolerancës në raport me diversitetin kulturor në shkollë dhe në shoqëri. Nëse ky proces do të ketë sukses, nxënësit/et do të jenë të mbështetur për të fituar përvojën e vetëveprimit dhe solidaritetit dhe për t'i zbuluar pikat e forta të personalitetit dhe aftësitë e tyre. Ata mësojnë t'i perceptojnë dhe t'i vlerësojnë aftësitë dhe potencialet e tyre të identitetit kulturor, etnik dhe shumëgjuhësor, si pjesë e identitetit të tyre dykulturore. Ata ballafaqohen me përkatësitë e ndryshme personale dhe me prejdardhjet kulturore, mësojnë t'i dallojnë të përbashkëtat dhe dallimet dhe nëpërmjet kësaj zbulojnë veçantinë dhe individualitetin e tyre. Në bazë të ngjashmërive dhe dallimeve brenda grupit, ata mësojnë të njohin përkatësitë e tyre transnacionale si diçka të vetkuptueshme në shoqërinë e globalizuar botërore. Në të njëjtën kohë, ky pranim dhe vlerësim i identiteteve të të gjithë nxënësve/eve me pjesët e personalitetit të tyre të ndryshëm social dhe kulturor, e përkrah bashkëjetesën dhe të mësuarit e përbashkët në klasë.

Të nëntë propozimet mësimore vijuese ndihmojnë në promovimin e përkrahjes së perceptimit, pasqyrimin dhe të aftësisë për të vepruar në kuadër të MGJP.

Si pikënisje shërbejnë shpesh përvojat identitare, burimet dhe potencialet e nxënësve/eve. Sigurisht luan rol të rëndësishëm edhe mësimdhënësi me përvojat e tij personale dhe me përvojat me të tjerët, të cilat i sjell si një burim për përgatitjen dhe zbatimin e mësimdhënies.

Se cila pjesë e kompetencave dhe në cilën njësi qëndron në plan të parë, shihet në tabelën e dhënë në fund të librit. Kategorizimet për klasat dhe nivelet janë përfshirë gjerësisht; shumica e propozimeve mund të zbatohen me modifikime të vogla edhe në ciklin e lartë apo të ulët.

# 1.1 Ky jam unë

## Qëllimi

*N mësojnë të njohin vetveten në bazë të simbolit të pemës. Ata i perceptojnë aftësitë e veta, interesat dhe nevojat e veta, dhe kështu mësojnë se sa të rëndësishëm dhe të veçantë janë ata. Mbi këtë bazë, ata mund të krahasohen me të tjerët dhe zbulojnë të përbashkëtat dhe dallimet.*

kl. 1-6

30-45 min.




Materiali:

Fletë pune me skicën e një peme

Rrjedha:

- N marrin një fletë në të cilën është e skicuar një pemë. Ata mësojnë se pema simbolizon vetë personin e tyre. Pjesët e pemës u përgjigjen këtyre kategorive (kjo duhet të diskutohet dhe nëpërmjet një shembulli të ilustrohet dhe të shënohet në dërrasë të zezë):
  - Rrënjët: nevojat themelore. Për çfarë kam nevojë gjatë jetës? Ku i kam rrënjët unë? (familja, ushqimi, banesa etj).
  - Degët: aftësitë/pikat e forta. Çfarë mundem unë? Cilat janë pikat e mia të forta?
  - Fletët: interesat/hobi. Cilët janë hobitë e mia? Çfarë më intereson?
  - Lulet ose frutat: dëshirat/ëndrrat. Çfarë dëshiroj unë për veten? Çfarë ëndrrash kam?
  - Trungu: Emri/nofka.



- N shkruajnë tek secila pjesë e pemës, atë që u përshtatet atyre. (N të vegjël u ndihmon M ose një shok klase). Më pas ata e ngjyrosin fletën.
- Reflektim dhe diskutim me tërë klasën: Secili/secila e paraqet pemën e vet dhe, me këtë, edhe personalitetin e vet. Është mirë që të jepen paraprakisht fillimet e fjalive dhe të shkruhen në dërrasë të zezë, p.sh. «Aftësitë e mia janë të ...», «Unë interesohem për ...». Në përfundim mund të diskutohen ngjashmëritë dhe dallimet – duke i përfshirë edhe ato të gjinisë dhe moshës.



# 1.2 Pamja e brendshme – pamja e jashtme

## Qëllimi

*N mendohen për perceptimin që kanë ata për veten e tyre dhe për të tjerët në lidhje me personin e tyre. Ata e pranojnë se pikëpamjet që kanë ata për figurën e tyre mund të ndryshojnë nga pikëpamjet që kanë të tjerët për ta dhe se perceptimi i huaj mund të ndihmojë për të mësuar më shumë rreth nesh dhe për të na zhvilluar edhe më tutje personalisht. Ata vetëdijësohen se njohja e perceptimit të huaj për ta është poaq e rëndësishme sa ajo e perceptimit që kanë ata për vetveten dhe se, që të dyja, ndikohen reciprokisht. Nëpërmjet kësaj ata përkrahen në lidhje me vetëreflektimin dhe aftësinë për kritikë.*

kl. 2–9

30–45 min.



Materiali:  
Skicimi i një personi  
(krahaso fletën në 3.2)


Udhëzime:


- Ushtrimi mund të çojë në vështrime shumë personale, ndoshta edhe në njohuri të dhimbshme, prandaj duhet të shoqërohet nga M me kujdes. N do të prezantohen para tërë klasës vetëm aq sa duan; në asnjë mënyrë nuk kërkohet që ata të «sqarohen tepër hapur».
- Referenca udhëzuese: Lojë shoqërore «Tash është radha jote»; Brosurë për mësuesit (...). Trajnimi për demokracinë për nxënësit/et e klasës 5 deri në 7. Vjegëza: [http://www.gesichtzeigen.de/wp-content/uploads/2008/06/begleit\\_gesell\\_05.pdf](http://www.gesichtzeigen.de/wp-content/uploads/2008/06/begleit_gesell_05.pdf).

Rrjedha:

- N marrin nga një fletë, me një skicë të personit, dhe do të udhëzohen gojarisht: në mënyrë individuale ata duhet të mbushin brendinë e skeletit, në të cilën do të shkruajnë mbiemra ose fjali të shkurta për veten e tyre (vetëperceptimi). Ata duhet të mendojnë për karakteristikat e veta, për pikat e forta, për dobësitë, për dëshirat, për ëndrrat etj. Kjo duhet të konkretizohet me disa shembuj. Plotësimi i tyre do të marrë rreth 10 minuta.
- Më pas, dy N ulen së bashku dhe shkëmbejnë përshkrimet e tyre, që i kanë shënuar në skicë. Në fletën e fëmijës tjetër shënojnë, me fjalë përmbledhëse ose fjali të shkurtra, se si e përjetojnë këtë (perceptimi i huaj, në lidhje me të njëjtat pika si te vetëperceptimi).
- Reflektim dhe diskutim me tërë klasën: si përputhen perceptimi për vetveten dhe perceptimi i huaj? Çfarë më ka habitur mua? Çfarë më ka gëzuar? Çka kam mësuar ose kam vënë re? Çfarë dua unë – pavarësisht nga perceptimi i të tjerëve – megjithatë ta mbaj, çfarë të ndryshoj?
- Nxitje për diskutim të mëtejshëm: Ne tani kemi njohur perceptimin e huaj në bazë të shënimeve të një nxënësi/eje të klasës. Por ka shumë njerëz të tjerë, të cilët më perceptojnë mua «nga jashtë» dhe më vlerësojnë. Si i përjetoj unë këto pikëpamje të jashtme, çfarë ndjenjash më shkaktojnë ato? (Këtu është fjala, gjithashtu, për të kuptuar diversitetin kulturor të mjedisit dhe për të reflektuar mbi rolin dhe ndikimin e tij mbi veten.)

Për klasat e ciklit të lartë ushtrimi mund të zgjerohet (p.sh. diskutimi i një liste të hollësishme të kategorive, të cilave u duhet kushtuar vëmendje; pikëpamjet e jashtme nga dy shokët e klasës, në vend të vetëm njërit). Në vend të imazhit me skicë, mund të shënohen shkallët për aspekte të caktuara (linja me vlerat nga 1–10 për aspektet si «sjellja ime sociale», «sjellja ime si nxënës/e», etj). Në këto shkallë mund të vendosen kryqe me ngjyra të ndryshme për perceptimin për vetveten dhe për perceptimin e të tjerëve. Të mundshme janë edhe intervista me njerëz të ndryshëm me të cilët tematizohen perceptimet për vetveten dhe ato për të tjerët.





# 1.3 Unë dhe të tjerët

## Qëllimi

Ushtrimi nxit N për ta parë më saktë dhe për të menduar rreth identitetit personal. Ky ndihmon për forcimin e identitetit, sigurisë në vetvete dhe në konsideratën për analizën personale. Ky ushtrim e përkrah perceptimin për pikat e forta personale dhe për pikat e forta të të tjerëve.

kl. 2-9

30-45 min.




Materiali:  
Fletë me tabelë qitjeje  
(dy fletë për nxënës/e)

Udhëzim:

- Analiza personale dhe ajo e jashtme ka si parakusht një shkallë të lartë të besimit në grup dhe kërkon nga M shumë takt. Është mirë që paraprakisht nëpërmjet shembujve të konkretizohet se në cilat fusha njerëzit mund të kenë pika të forta (kompetenca sociale, anët e forta në fushën shkollore, anët e forta të karakterit etj.) Ushtrimi gjithashtu mund të kryhet edhe sipas grupeve gjinore, ku pastaj krahasohen dhe diskutohen fuqitë e vajzave dhe të djemve.
- Referenca: Përmbledhje e metodave vendi i mësimi – stadiumi. Edukimi politik në qendrat e mësimi në stadiumet e futbollit. Fondacioni Robert Bosch në bashkëpunim me Fondacionin e ligës federale. Kapitulli 3: Identiteti. Vjegëza: [www.bosch-stiftung.de/content/](http://www.bosch-stiftung.de/content/).

Rrjedha:

- N formojnë grupe dyshe. Çdo fëmijë do të marrë dy fletë, ku secila prej fletëve ka një tabelë qitjeje; secili e shkruan fletën me emrin e tij dhe një me emrin e fëmijës tjetër.



- Së pari, N shënojnë në tabelën e qitjes së tyre pesë pikat e tyre të forta personale. Sa më shumë që ata vlerësojnë pikat e forta të tyre, aq më afër qendrës së shkallës së qitjes i shënojnë ato.
- Tani kryejnë të njëjtin ushtrim në raport me partnerin e tyre. Në vazhdim i krahasojnë së bashku rezultatet.
- Reflektim dhe diskutim me tërë klasën: Si e përjetuat ushtrimin? A pati dallime të mëdha në mes të perceptimit tuaj dhe atij të partnerit? Çfarë e bën një anë të fortë? A mund të bëni diçka vetë për anët tuaja të forta? A është e mundshme që, ndoshta, edhe anët e dobëta të bëhen anë të forta?
- Pikat kryesore të vlerësimit duhet të jenë, në radhë të parë, llojllojshmëria e pikave të forta dhe potencialet e ndryshme, së dyti, diskutimi i çështjes «Cilat anë të dobëta duam t'i tejkalojmë, për çfarë lloj përkrahjeje kemi nevojë?».

# 1.4 Më lejoni të fluturoj!

## Qëllimi

*N reflektojnë përmes simbolit «Dragoi i erës» identitetin e tyre kulturor me të gjitha përkatësitë dhe rolet e tyre. Ata e kuptojnë se ata nuk janë thjesht vetëm midis dy kulturave apo vendeve, por se ata kanë edhe potencial të vlefshëm transnacional dhe dykulturor si dhe përkatësitë e tyre.*

kl. 4–9

rreth 2 orë



### Materiali:

Fletë pune me dragoin fluturues me sqarime; dragoj të erës të shtypur në të dy anët si shembull; shirita letre për bishtin; penj të trashë dhe lapsa me ngjyra

### Udhëzim:

Reflektimi mbi identitetin personal multikulturor mundëson për ta zgjeruar në një projekt dy deri trejavor, në të cilin, pjesë të veçanta ose aspekte të dragoit të erës, mund të trajtohen në thellësi. Pyetjet e reflektimit do të përshtaten sipas niveleve të veçanta. Projekti gjithashtu është i përshtatshëm edhe për zbatimin e përbashkët me mësuesit e klasëve të rregullta ose me përfshirjen e prindërve. Një kulminacion i bukur krijohet, kur me rastin e përfundimit të projektit, dragojt e erës lëshohen të ngrihen lart. Kjo kërkon, megjithatë, që ata të përpunohen nëpërmjet një pune plotëse ose në letër të përshtatshme dhe të ndërtohet një skelet i aftë fluturues.

### Rrjedha:

- Në fillim të sekuencës M e paraqet dragoin fluturues me pjesët e tij si një figurë-simbol për identitetin. Ai tregon një dragua të prerë, si shembull të produktit përfundimtar dhe shpjegon fletën e punës. Në këtë fletë pune, dragoi është ilustruar si dhe është shkruar se për çfarë janë pjesët veç e veç. Çdo pjesë paraqet një mjedis të jetesës dhe pjesë të identitetit, për shembull, familja, shkolla, miqësia, fqinjësia etj.; për çdo pjesë të identitetit dhe mjedisit jetësor është një rol i caktuar – vajza, djali, nxënësi/ja, miku/ja, të afërmit etj. Shuma e të gjitha identiteteve të pjesshme dhe e roleve e përbën personalitetin dhe identitetin tim. Lidhur me këtë duhet të zhvillohet një bisedë hyrëse, në mënyrë që të gjithë N t'i kuptojnë këto detyra.
- Së pari, N modelojnë një smiley (fytyrë e qeshur) në mes të dragoit (të vizatohet fytyra ose të ngjitet fotoja). Rreth smiley-t shkruhen shkurtimisht informacionet më të rëndësishme për veten (mosha, klasa, vëllezërit e motrat, gjuha, disa veti ...).
- Pastaj emërtohen pjesët e tjera të dragoit. Sipas legjendës, në fletë ata bëjnë shënimet e tyre mbi aspektet individuale. Është mirë që pjesa e përparme e dragoit të përdoret për mjedisin e jetesës në vendin e emigracionit, kurse pjesa e pasme për atë në vendin e prejardhjes. Nëse gjashtë trekëndëshat nuk janë të mjaftueshëm, mund edhe (një ose disa prej tyre) të përgjysmohen.
- Në një hap tjetër në klasë do të tematizohen dhe do të bëhen të qarta për të gjithë përkatësitë e shumëllojshme dhe të njëkohshme, gjegjësisht identitetet e pjesëshme. Për këtë qëllim, M thërret emrat e pjesëve identitare dhe roleve (si p.sh. «kushërirë», «sportist», «nxënëse/e», «anëtar shoqate»). Kush ka në dragoin e tij një shënim për këtë ngrihet në këmbë dhe flet.
- Është e mundshme që, para ose pas këtij hapi, dragojt e erës të prezentohen dhe të shpjegohen në grupe katërshe. Si shtysë për këtë, M mund të shënojë në tabelë pyetje të tilla nxitëse si në vijim: çfarë e përbën identitetin tim? Cilat janë pjesët kryesore të identitetit tim? Cilave grupe e ndiej se u përkas unë? Cilat janë pikat e forta dhe burimet që kam unë në bazë të identiteteve të mia të pjesshme/të mjedisëve jetësore? Çfarë është e rëndësishme për mua? Çfarë besimesh, normash dhe idesh kam përvetësuar unë?

- Në një diskutim përfundimtar përmbyllës do të duhej të reflektohet dhe të diskutohet ndikimi i pjesëve të ndryshme të identitetit. Shtysat për këtë duhet të jenë të përshtatura sipas moshave; në qendër do të jenë pyetjet e natyrës së mëposhtme:
  - Cilat pjesë të identitetit janë veçanërisht të rëndësishme për ju dhe pse?
  - Cilat pjesë të identitetit nuk janë fare të rëndësishme për ju dhe pse?
  - A ka pjesë ose role, që janë të rëndësishme kryesisht (ose vetëm) në vendin tuaj të prejardhjes?
  - A ka një hierarki në mesin e identiteteve të pjeshme?
  - A ka pjesë të identitetit, të cilat u atribuohen juve nga jashtë, nga shoqëria, edhe pse ju nuk mund të identifikoheni me to?
  - Çfarë roli luajnë gjuhët tua për identitetin tënd?
  - Cilat pjesë të roleve marrin shumë hapësirë në simbolin e dragoit të erës, e cilat shumë pak?
  - A ka role që ti i pëlqen veçanërisht, përkatësisht më shumë nuk i pëlqen?
  - A ka konflikte apo mospërputhje ndërmjet këtyre roleve, apo e plotësojnë njëra-tjetrën?
  - A ke mësuar diçka të re për veten dhe për grupin?

## Fletë pune me dragoin e erës dhe përshkrimi i pjesëve (shih më poshtë)

Smiley (fytyra e qeshur)  
në mes: Ky jam unë!  
*Çfarë më bën të veçantë?  
(profil i shkurtër.)*

Gjashtë trekëndësha:  
Vendet, situatat, mjediset  
jetësore, në të cilat unë  
lëviz. *Cilave grupe u përkas  
unë? Çfarë rolesh kam unë  
në to?*

Tre penj dragoi në mes:  
aftësitë e mia, anët e forta,  
resurset, gjuhët, interesimet  
për hobi. *Çfarë mund të  
bëj unë? Cilat janë anët e  
mia të forta?*

Peri i dragoit në mes:  
Dëshirat e mia në të  
ardhmen dhe ëndrrat.

Dy bishta të dragoit: perceptimet  
e mia për botën, religjioni im,  
pikëpamjet e mia për botën.  
*Çfarë është për mua e rëndësishme?  
Çfarë besimesh, normash dhe idesh  
kam marrë unë?*

Era, ajri: shoqëria, në të cilën  
unë jetoj, me të gjitha kushtet.  
*Cilat janë pritjet që ka shoqëria  
për mua? Çfarë pres dhe kam  
nevojë nga shoqëria?*

Bishti i gjatë i dragoit: rrënjët e  
mia, familja, prejardhja, e kaluara.  
*Prej nga vij unë? Kush ose cilat  
ngjarje kanë ndikuar tek unë?*

# 1.5 I pranuar – i përjashtuar

## Qëllimi

N përjetojnë nëpërmjet luajtjes së roleve se si, në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, përjashtohen nga grupi. Reflektimi për ndjenjat, me të cilat lidhet ky përjashtim dhe përpunimi i mundësive për të vepruar, i përkrahin ata në kompetencat sociale dhe vepruese.

kl. 4–9

60 min.



Materiali:

Kompleti me pesë karta të roleve. Katër karta janë identike, e pesta është ndryshe. (Shih shembullin poshtë.)

Udhëzime:

- Është ndihmuese, nëse N tashmë kanë përvojë me luajtjen e roleve. Rregull i rëndësishëm: Komentet mund të jepen vetëm pas lojës, por jo gjatë lojës!
- Burimi: [http://www.fippev.de/t3/fileadmin/fippev/userdaten/PDF/Anti-Bias-Ordner/Diskriminierung\\_Antibias\\_in\\_der\\_Schule.pdf](http://www.fippev.de/t3/fileadmin/fippev/userdaten/PDF/Anti-Bias-Ordner/Diskriminierung_Antibias_in_der_Schule.pdf).

Rrjedha:

- Informacioni për N: Nëpërmjet luajtjes së roleve duhet të paraqitet një situatë, në të cilën katër persona diskutojnë me pasion mbi një temë, kurse personi i pestë është i përjashtuar nga ky diskutim (shih shembullin e mësipërm. Shembuj të tjerë: 4 karta për temën «Pushimet në det», 1 kartë «Pushimet në mal», 4 karta për temën «Telashe me mësuesit», 1 kartë «Përvojat pozitive shkollore»)
- Pesë vullnetarë do të marrin nga një kartë dhe bëjnë një bisedë për të (ku natyrisht së shpejti shihet që dikush flet vazhdimisht jashtë temës në fjalë). Këta pesë N ulen në një rreth në mes; të tjerët ulen rreth e rreth. Luajtja e rolit zgjat jo më shumë se 10 minuta. Në qoftë se ka kohë të mjaftueshme në dispozicion, luajtja e roleve mund të përsëritet me një komplet tjetër të kartave.

1

## Shembull për kartat e roleve



- Reflektim përfundimtar dhe diskutim me tërë klasën rreth pyetjeve kryesore si:
  - Si ndiheshin pjesëmarrësit gjatë lojës, si ndiheni tani?
  - Çfarë kanë parë vëzhguesit/et?
  - Lidhur me mekanizmat e përgjithshëm dhe motivet e përjashtimit: pse ndodhi në lojën
  - tonë përjashtimi dhe çfarë situatash të tjera të përjashtimit dini ju? Si do të mund të shmangej përjashtimi i dhimbshëm?

- Eventualisht njohja e situatave të përjashtimit, të cilat janë karakteristike për shoqërinë tonë; diskutimi i strategjive për t'i ndryshuar këto situata.

# 1.6 Molekula personale e identitetit

## Qëllimi

*N pasqyrojnë identitetin e tyre kulturor dhe perceptojnë ngjashmëritë dhe dallimet. Ata njohin përkatësitë e tyre të ndryshme grupore, përkatësinë në grupet e pakicave, apo grupet shumicë dhe përvojat e lidhura me to.*

kl. 4–9

45–90 min.



Materiali:  
Fletë pune: molekula e identitetit  
(shih më poshtë).

Udhëzim:


Burimi: Sipas «A World of Difference»; Institute Training Manual, ©1994 Anti-Defamation League.

Rrjedha:

- N marrin fletën e punës «Molekula ime personale e identitetit» dhe mësojnë se për çfarë po bëhet fjalë. Në një diskutim të shkurtër me klasën dhe më pas individualisht, ata mendojnë rreth grupeve të ndryshme të cilave e ndjejnë se u përkasin.
- Në vazhdim shkruajnë emrin e tyre në qendër të rrethit dhe pastaj, në qarqet rreth e rreth, emrat e grupimeve të ndryshme, të cilave ata e ndjejnë se u përkasin (familja, shkolla, koha e lirë; të afërmit në vendin e prejardhjes, chat-grupet, Facebook miqtë/mikeshat etj.).
- Në një hap të dytë, M zhvillon një «ushtrim-ngritjeje» për t'i bërë të dukshme përkatësitë grupore. M i thërret disa grupe të mundshme, si («klubi i futbollit», «të afërmit në vendin e prejardhjes» etj). Nxënësit/et, grupi i të cilëve thirret, ngrihen në këmbë dhe, ndoshta, japin një koment të shkurtër. Pastaj thirren edhe kategoritë që nuk janë emërtuar, por që gjenden në fletë.
- Në hapin e tretë, N formojnë ekipet dyshe (mundësisht me dikë me të cilin, përndryshe, nuk kanë shumë kontakte). Secili ekip diskuton se cilat grupime dhe përkatësi kanë ndikuar veçanërisht, çfarë ndikimi kishin personat e ndryshëm në ngjarjet shoqërore, politike, personale dhe çfarë ndikimi kanë në mjediset e ndryshme jetësore (në familje, në kohën e lirë, në kulturën dhe traditat kombëtare). Ku qëndron rëndësia e veçantë dhe vlera e të qenit anëtar i këtij grupi, çfarë e bën të lehtë apo të vështirë të jesh anëtar i këtij grupi? Nxitjet për diskutimet në dyshe duhet të caktohen paraprakisht.
- Fundin e sekuencës e krijon reflektimi me tërë klasën. Shtysat për këtë qëllim:
  - Cilat ishin pikat kryesore që keni diskutuar në grupet dyshe?
  - A ka përjetuar ndokush diçka të re ose të papritur rreth vetes?
  - A ka vënë re ndokush diçka interesante gjatë ushtrimit të ngritjes në këmbë ose gjatë diskutimit në grupet dyshe (p.sh. sjellje të veçanta gjinore apo sjellje të veçanta për sa i përket moshës.)?
  - Cilat përkatësi grupore mund të përjetohej si problematike dhe të dhimbshme?



- Cilat përkatësi grupore mendoni se janë të njohura në shoqëri, e cilat nuk janë?
- Për të diskutuar çështjen e fundit, mund të flitet, së pari, për përkatësitë grupore të ndryshme nga ana shoqërore (të pasur – të varfër, të huaj – vendas, femër – mashkull, të krishterë – muslimanë, heteroseksualë – homoseksualë, etj). Më pas, për shembull, me anë të një shkalle mund të diskutohen përparësitë dhe papërparësitë e përkatësisë në këto grupe dhe pranimi i tyre. Burimi: Sipas «A World of Difference»; Institute Training Manual, ©1994 Anti-Defamation League.



## 1.7 Bashkërisht jemi të fortë

### Qëllimi

Nëpërmjet parimit të fuqisë kolektive N mësojnë se varësia e ndërsjellë nuk do të thotë heqje dorë nga identiteti i vet. Në mënyrë konkrete bëhen të qarta përparësitë, që rezultojnë kur je i përkrahur nga një grup.

kl. 7–9

30 min.



Materiali:  
degë ose shkopinj prej druri  
(në diametër rreth 5 mm,  
rreth 30–40 cm të gjatë, dy për  
nxënës/e), penj të trashë,  
etiketa të vogla letre.


Udhëzim:

Burimi: Schilling, Dianne (1993): Miteinander klarkommen. Toleranz, Respekt und Kooperation trainieren. Mülheim an der Ruhr: Verlag an der Ruhr.

Rrjedha:

- Do të formohen grupe prej 6 deri 12 N. Çdo nxënës/e e merr një shkop ose degë. M sqaron se shkopinjtë i përfaqësojnë ata vetë dhe se ata duhet të imagjinojmë se shkopinjtë i kanë të gjitha pikat e forta, dobësitë dhe ndjenjat të cilat i kanë ata vetë si individë. M shpjegon se trysnia dhe stresi, që njerëzit i përjetojnë në jetën e tyre, mund të çojnë deri aty sa ata të përkulen dhe nganjëherë edhe të thyhen. Kjo do të ilustruhet praktikisht ashtu që N të thyjnë shkopinjtë e tyre.

- Kur të gjithë N kanë thyer shkopinjtë e tyre, M u jep mundësinë që nxënësit veç e veç të tregojnë dhe të informojnë se sa ishte e nevojshme për të bërë trysni për këtë – shumë, pak, mesatarisht, ose jashtëzakonisht shumë. Kështu do të dalë në pah se disa mund ta thyenin lehtë shkopin e tyre, ndërsa të tjerët duhej të përpiqeshin më shumë.



- Gjatë diskutimit do të sqarohet se – ashtu si shkopinjtë – edhe njerëzit mund t'i rezistojnë në shkallë të ndryshme trysnisë që sjell me vete jeta. Se sa stres mund të durojë dikush, varet shumë nga ajo se me sa efektivitet mund të merret ai/ajo me stresin. Edhe personi më i fortë mund të thyhet, në qoftë se trysnia është shumë e madhe.
- Pastaj, pjesa tjetër e shkopinjtve ose degëve do të shpërndahen bashkë me nga një etiketë. Të gjithë e shkruajnë emrin e tyre në etiketën e vet dhe e ngjisin në shkopin e vet. Shkopinjtë do të mblidhen dhe do të lidhen së bashku në një deng. Tani M u bën thirrje N të ndryshëm për të thyer një deng të tillë vetëm me duar. Kjo tregon se edhe njerëzit shumë të fuqishëm do të kishin vështirësi të mëdha me këtë detyrë.
- Nxitje për reflektim përfundimtar dhe diskutim me tërë klasën:
  - Çfarë ka të bëjë ky ushtrim me ne, çfarë përjasjesh mund të bëhen?
  - Cili është dallimi ndërmjet identitetit personal dhe identitetit të grupit?
  - Cilat janë përparësitë e të punuarit në grupe?
  - Çfarë ndodh me identitetin individual, kur një person bëhet anëtar i një grupi?
  - Kur dhe në cilat fusha mund t'i ndihmojë një grup dikujt për të përballuar vështirësitë e jetës dhe për të kryer detyrat; kur dhe deri në ç'pikë?

**Njësia 2:  
Historitë e migrimit –  
bota në klasën tonë**



Nxënësit/et e MGJP, ashtu si gjithë fëmijët dhe të rinjtë e tjerë, kanë biografi të veçanta. Ajo që i dallon ata nga fëmijët dhe të rinjtë «vendas» të rritur në mjedisin njëkulturore dhe i bën ata të veçantë, është historia e tyre – qoftë kur ata e kanë përjetuar vetë migrimin, qoftë kur janë rritur si fëmijë apo nipa/mbesa të prindërve ose gjyshërve të emigruar. Në të dyja rastet, sfondi i emigrimit është një burim i pranishëm tek këta të rinj, edhe pse këta nuk e marrin vlerësimin përkatës në shoqëri.

Në MGJP, sfondi i emigrimit, origjina e kulturës dhe jeta në kultura dhe mes kulturave të ndryshme përbëjnë temat kryesore. Nëpërmjet trajtimit të historisë personale të emigrimit, pasqyrohet ndikimi i emigrimit në biografinë personale dhe kështu nxënësit/et bëhen të vetëdijshëm për sfidat me të cilat ata duhet të përballen në vendin mikpritës. Nga ana tjetër, ata bëhen të vetëdijshëm për resurset e tyre specifike dhe mësojnë se si mund t'i përdorin këto në jetën e përditshme. Ata mësojnë ta njohin procesin e emigrimit, si pjesë të historisë së familjes së tyre, dhe zhvillojnë respektin dhe vlerësimin për veten e tyre, për të arriturat dhe përvojat e prindërve dhe të gjyshërve.

Përveç historisë së vet të migrimit, nxënësit/et duhet të ballafaqohen edhe me atë të kolegëve/eve dhe njerëzve të tjerë nga rrethet e kulturave të ndryshme në lagje, në mënyrë që të mund të përjetojnë diversitetin kulturor në mënyrë të vetëdijshme dhe ta bëjnë atë të dukshëm. Në bazë të analizës së biografive të huaja të migrimit, ata mund të mendojnë sërish në lidhje me historinë e vet, si dhe të kenë gjithashtu mirëkuptim për të tjerët. Ky mësim biografik ua mundëson atyre për t'i njohur shkaqet e shumta dhe pasojat e migrimit, si dhe për të mësuar mbi shanset dhe sfidat në bashkëjetesën e njerëzve me kultura të ndryshme. Në të njëjtën kohë ata mësojnë, në këtë ballafaqim me biografitë e migrimit në nivele të ndryshme, për të kuptuar raportin shoqëror, politik dhe ekonomik me migrimin dhe për të zhvilluar strategjitë dhe mundësitë e tyre për veprim. Ata zhvillojnë tolerancën dhe miratimin për diversitetin kulturor dhe gjuhësor dhe me këtë zgjerojnë edhe kompetencat e veta ndërkulturore.

Bazën për të shtatë propozimet mësimore në vijim e formojnë përvojat identitare, resurset dhe potencialet e nxënësve/eve. Sigurisht, një rol të rëndësishëm luan edhe mësimdhënësi me përvojat personale dhe të jashtme, të cilat i ka si resurs për shfrytëzim në përgatitjen e njësive mësimore.

Kategorizimet për klasat dhe nivelet janë shumë të gjera; shumica e propozimeve mund të zbatohen me përshtatje përkatëse në nivelet e veçanta.

Tri propozimet (2.7 a-c) kanë të bëjnë me projekte më të gjera, të cilat janë veçanërisht të përshtatshme si projekte bashkëpunimi me mësimin e rregullt në kuadër të ditëve të projektit apo javëve të projektit.

# 2.1 Të shpërndarë nga era

## Qëllimi

*Nëpërmjet paraqitjes së rrjetit të vet të marrëdhënieve me njerëz të ndryshëm, gjuhë dhe vende, N e bëjnë të qartë historinë e tyre të migrimit dhe e perceptojnë migrimin si diçka të përditshme dhe të vetëkuptueshme.*

kl. 1-9

90 min.



Materiali:

hartat ose copa të mëdha shiritash letre për të shënuar vendet ose rajonet, shirita letre bosh; grafika nga stërvitja 1.6 «Molekula personale e identitetit».

Rrjedha:

- Në klasë do të vendosen hartat e vendeve (vendi i prejardhjes ose vendi i emigrimit, Evropa dhe hartat e botës). Nga ana tjetër, do të vendosen në mure emrat e vendeve të shkruara në shirita letre. Gjithashtu edhe katër pikat e busullës mund të merren si udhëzues. Në mes të dhomës qëndron një shenjë me emrin e tanishëm të qëndrimit dhe të vendit të shkollës.
- M kërkon nga N që, në bazë të hartave, të pozicionohen në vendin e parë të lindjes, pastaj te vendlindja e babait dhe/ose e nënës dhe pastaj tek vendlindja më e largët e gjyshërve.
- Pas kësaj hyrjeje të përbashkët N punojnë individualisht për historinë e tyre të migrimit në të cilën ata vizatojnë në një fletë (A4) rrjetin e tyre të marrëdhënieve, të përbërë nga persona referimi, të afërmit, vëllezërit e motrat me gjuhët e tyre përkatëse, qytetet e shtetet. Si model shërben paraqitja tek «Molekula personale e identitetit» (shih më lart 1.6), ku me rrethin në mes përfaqësohet vendndodhja aktuale, kurse rrathët e jashtëm paraqesin vendet e origjinës. Rrathët e afërt do të përdoren për vendet ku N i kanë prindërit, vëllezërit e motrat dhe gjyshërit e të cilët edhe i vizitojnë. Emrat e personave do të shënohen në rrathët përkatës. Madhësia e shkronjave të një emër mund të tregojë edhe shkallën e rëndësisë së individit. Rrathët më të largët do të përdoren në përputhje për vendet, ku ata i kanë të afërmit e panjohur, të cilët nuk i kanë parë kurrë, ose nuk i njohin mirë. N e rritur, në vend të kësaj paraqitjeje, mund të skicojnë ose të kopjojnë një hartë të Evropës, ose të botës, dhe të dokumentojnë në të rrjetin e tyre të kontakteve.
- Prezantimi dhe diskutimi i disa krijimeve para tërë klasës. Një reflektim i përbashkët mbi prejardhjet, arsyet e migrimit etj., me tërë klasën mund të bëhet në bazë të pyetjeve të përzgjedhura nga ushtrimi 2.7a.
- Puna e mëtejshme e mundshme: intervistë me prindërit rreth historisë së tyre të migrimit (shih 2.3);

# 2.2 Historitë e migrimit në klasën time

## Qëllimi

*N hulumtojnë në një projekt-intervistë historinë e migrimit të kolegëve/eve të tyre. Në bazë të ngjashmërive dhe dallimeve do të pasqyrohet ndikimi i migrimit në biografinë personale.*

kl. 3–9

90 min.



Materiali:

Fletë pune me pyetjet e intervistës (do të përpunohet me klasën), ndoshta fletë A3

Udhëzim:

M do t'i njoftojë N, një ose dy javë më parë, për projektin, në mënyrë që ata të mund të informohen në shtëpi dhe ndoshta mund të marrin me vete ndonjë objekt të rëndësishëm për ta (p.sh. një suvenir). Projekti është gjithashtu një përgatitje e mirë për intervista me prindërit dhe për të hulumtuar historitë e migrimit të personave të tjerë në lagjen e banimit, shih më poshtë 2.3 dhe 2.7a dhe b. Ky projekt është i përshtatshëm edhe për të bashkëpunuar me mësimin e rregullt.

Rrjedha:

- M do t'i informojë N për projektin. Do të diskutohet dhe do të ilustrohet me shembuj se çfarë pyetjesh mund të shtrohen në intervistat. Fushat që mund të adresohen në një intervistë: shkaku dhe koha e migrimit, kontaktet me vendin e prejardhjes, jeta në vendin e emigracionit, perspektivat e ardhshme etj. Krahaso edhe pyetjet në 2.7a.
- Edhe forma se si do të shtrohen pyetjet, duhet të diskutohet dhe të ilustrohet me shembuj (jo çështje të ngushta, të cilat mund të kenë përgjigje vetëm po ose jo; shumë më vlefshme janë shtysat, të cilat e nxisin të intervistuarin për të treguar!).
- N ulen bashkë në grupmosha të njëjta ose në grupe të përziera (eventualisht grupe dyshe) dhe përpunojnë një katalog me 4–6 pyetje për intervistë. Para këtyre pyetjeve do të duhej të regjistrohen dhe shënohen: emri, mosha, rajoni i prejardhjes dhe vendi i lindjes.



- Nga dy N e intervistojnë njëri-tjetrin për temën e migrimit, sipas pikave të mësipërme të përpunuara. Intervista do të duhej të zgjasë pesë deri dhjetë minuta. Më pas, rolet mund të ndërrohen.
- Në qoftë se ka kohë të mjaftueshme në dispozicion, N mund të bëjnë një poster për partnerin e tyre të intervistës/për partneren e tyre dhe pastaj ta prezantojnë në bazë të posterit. Posterat mund të varen në mur për përpunim të mëtejshëm ose të ekspozohen për një takim me prindër me titull «Historia e migrimit e javës».

- Nga M do të moderohet diskutimi i përfundimtar në klasë në të cilin fushat e temave të caktuara më sipër (Arsyet e migrimit etj.) do të shikohen nëpërmjet krahasimeve të ndërlidhura. Shtysat për këtë: Çfarë ngjashmëri dhe dallimesh vini në dukje ju? Pse migrojnë njerëzit; Cilat janë arsyet më të shpeshta për migrimin? Ku, si dhe çfarë do të ishit sot, në qoftë se ju ose prindërit (gjyshërit) tuaj nuk do të kishin emigruar? (Eventualisht tekst për këtë.)

## 2.3 Biografia ime e emigrimit si burim force

### Qëllimi

*N hulumtojnë se prej nga e marrin forcën e tyre, çfarë resursesh kanë dhe çfarë roli luan si resurs historia e tyre e emigracionit.*

kl. 2-9

45-90 min.



Materiali:

Një «ilustrim dielli» (shih më poshtë), si një mostër; letër, ngjyra.

Udhëzime:

Për të shmangur keqkuptimet, M mund të marrë kontakt paraprakisht me prindërit dhe t'ua sqarojë qëllimin e veprimtarisë (ndërgjegjësimin pozitiv për resurset). Veprimtaria është gjithashtu e përshtatshme edhe si projekt bashkëpunimi me klasat e rregullta.


Rrjedha:

- M i informon N: Këta do të duhej të intervistojnë prindërit, vëllezërit e motrat, miqtë dhe të afërmit për resurset, të cilat këta të afërm i perceptojnë dhe i vlerësojnë tek N.
- Me tërë klasën ose në grupe do të mblidhen pyetjet për këtë intervistë. Shembuj: Çfarë të pëlqen ty në lidhje me mua? Çfarë vlerëson ti tek unë? Çfarë është cool tek unë? Çfarë të mrekullon tek unë? Çfarë vlerëson tek unë? etj.
- Së bashku skicohet një pyetësor; ndoshta në dy ose tri versione të ndryshme sfiduese. Secili/a N duhet të ketë të plotësuar, të paktën, tre pyetësorë.
- N ua shpërndajnë pyetësorët njerëzve përkatës për t'i mbushur ose e plotësojnë atë me ta së bashku. Pyetësorët mund të plotësohen me të afërmit në vendet e tyre të prejardhjes, nëpërmjet thirrjeve telefonike (Skype).
- Vlerësimi i pyetësorit në javën e ardhshme (secili/a e vlerëson ose pyetësorin e vet ose të një kolegu/një kolegeje): Së pari, në formën e fjalëve kryesore; pastaj si «ilustrim dielli» (dielli si simbol i fuqisë dhe i energjisë; shih figurën më poshtë). Për këtë N ngjyrosin, në anën e djathtë të skajit të letrës, një diell dhe shkruajnë mbi të emrin e tyre. Në drejtim të diellit tërheqin shigjetat në trashësi dhe ngjyra të ndryshme; në këto shigjeta do të shënohen deklaratat nga pyetësori (p.sh., «Unë e admiroj këmbënguljen tuaj»). Shigjetat tregojnë se prej nga dielli (përkat. fëmija në fjalë) e merr fuqinë e tij. Çdo shigjetë simbolizon një burim të fuqisë dhe njohjes. Te çdo shigjetë është edhe emri i personit nga i cili vjen deklarata përkatëse.
- Në grupe N i prezantojnë diejt e tyre dhe burimet e tyre personale të energjisë; në përfundim këto mund të ekspozohen në një takim me prindërit.



- Shtysa për një vlerësim përfundimtar me tërë klasën:
  - Çfarë burimesh të energjisë kam ende për të përbushur biografinë time të migrimit?
  - Si kanë ndryshuar burimet e mia të fuqisë në rrjedhën e jetës?
  - Si kanë ndryshuar burimet e mia të fuqisë në rrjedhën e jetës sime?
  - Çfarë mund të bëj tjetër me burimet e energjisë sime?

## Shembull Ilustrimi i diellit



## 2.4 Atdhetë e mi – tregime autobiografike

2

### Qëllimi

Pyetjes për Atdheun dhe identitetin personal nganjëherë është e vështirë t'i përgjigjen fëmijët dhe të rinjtë me sfond emigrimi. Në ushtrimin «Atdhetë e mi», N tregojnë përndarjen gjeografike të lidhjeve të tyre të shkaktuara nga migrimi dhe do të duhej që nëpërmjet rrëfimit autobiografik të perceptojnë se si biografia e tyre e emigrimit është ndikuar e ndikohet nga persona të caktuar, vende dhe ngjarje. Ushtrimi i lejon ata që të merren në mënyrë krijuese me temën «Atdheu».

kl. 4–9

45–90 min.



#### Materiali:

Portretet personale të N, foto familjare, fotot e prindërve dhe anëtarëve të familjes, fotot me të afërmit dhe miqtë, etj; Kopje në A3 të një harte të botës (ndoshta vetëm të Evropës).

#### Rrjedha:

- Një javë më parë N marrin për detyrë që të sjellin një foto të vogël portret (ose viza tim) të veten si dhe foto të ndryshme dhe foto në grup të anëtarëve të familjes shokëve/eve dhe të të njohurve.
- Në fillim të orës N ulen në një rreth në dysheme dhe e marrin nga një hartë të botës (ose të Evropës) të kopjuar në A3 me emrat e vendeve. Së pari, ata duhet të ngjitin foton e tyre individuale në vendndodhjen aktuale. Së dyti, ata duhet që, të gjitha vendet, qytetet dhe lokalitetet e tjera, me të cilat kanë kontakt në çfarëdo forme, t'i rrethojnë me ngjyrë dhe ndoshta edhe të shkruajnë emrin e tyre. Në vazhdim lidhin foton e tyre me një linjë me ngjyrë me vendet ose qytetet e rrethuara.
- Në një punë individuale ata mendohen se nëpërmjet cilit anëtar të familjes, me cilët persona mbajnë marrëdhënie në atë shtet ose vend dhe e ngjitin foton e sjellë, që korespondon me vendin përkatës.

- Si hap përfundimtar ata kujtohen për një përvojë të përbashkët me këtë person dhe e shkruajnë këtë me një fjali mbi linjën lidhëse (ka festuar ditëlindjen, ka marrë një dhuratë, e ka ndihmuar për detyrat e shtëpisë, ka treguar një histori, i ka mësuar shkrimin etj.). Edhe ngjarjet negative duhet të kenë hapësirë këtu. Fillimet e fjalive fillojnë në këtë rast me një shenjë minus.
- Në grupe katërshe ata i tregojnë njëri-tjetrit biografinë e tyre të vizualizuar të migrimit dhe komentojnë për personat e ndryshëm, vendet e ngjarjet.
- Vlerësimi përfundimtar me tërë klasën; Pyetjet dhe vlerësimet për këtë:
  - Çfarë do të thotë «Atdheu» për ty? Ku është ky, pse?
  - Me çfarë e lidh ti në radhë të parë nocionin «Atdheu»? (vendbanimi, vendi i lindjes, familja, miqtë etj)
  - A i ke theksuar disa vende, si Atdheu yt? Nëse është kështu, cilat dhe pse?
  - Sa e rëndësishme është për ty, që ti të ndihesh si në shtëpi në vendin tënd të banimit (shkalla nga 0–5)?
  - Si e arrin këtë që vendi, në të cilin jeton tani, të bëhet Atdheu yt?
  - A e humb prejardhjen tënde kulturore, nëse edhe këtu është Atdheu yt?
- Thellim i mundshëm: intervista me njerëz të ndryshëm për temën Atdheu.

## 2.5 Më herët – sot – nesër

### Qëllimi

*N sigurojnë një përshtypje të përgjithshme të biografisë së tyre të migrimit nëpërmjet një linje kohore. Kjo ua mundëson atyre, në një rën anë, për të reflektuar mbi ndikimin e migrimit në biografinë e tyre dhe, në anën tjetër, për t'u ballafaquar me interesat, dëshirat dhe shpresat e tyre.*

kl. 4–9

90 min.



Materiali:  
fletë A3 për kohën ose linjën jetësore  
(shih më poshtë).


Udhëzim:

Ushtrimi gjendet te Gudjons, H., Wagner Gudjons, dhe B. Pieper, M: (2008): Auf meinen Spuren. Ushtrime për punë biografike. Bad Heilbrunn: Klinkhardt.

Rrjedha:

- N marrin shënim si një hyrje me këto pyetje vijuese, të cilave ata (pas një një udhëzimi dhe sqarimi me tërë klasën) u përgjigjen për vetveten:
  - a) Kur isha 8 vjeç:  
Një interesim kryesor ...  
Një problem, një vështirësi...  
Një shpresë, një dëshirë...
  - b) Tashti në jetën time:
  - c) Në 10 vjet:

## Shembull Linja e kohës ose e jetës



- Në një fazë të dytë, ata vizatojnë në një fletë A3 një linjë kohore ose jetësore, që fillon me 0 (= lindja) dhe shtrihet deri në 25. Në nëpërmjet punës individuale mendohen se cilat ngjarje të rëndësishme duan t'i shënojnë në këtë linjë kohore. Ngjarjet e perceptuara si negative shënohen nën linjën kohore, kurse përjetimet pozitive mbi linjën kohore. Për situatat e tranzicionit (hyrja në shkollë, migrimi, fillimi i jetës profesionale, ndoshta formimi i familjes, emigracioni etj.) mund të krijohen edhe simbole.
- Fletët me linjë kohore ose jetësore do të varen në mur, shikohen, komentohen dhe diskutohen. Këtu shkëmbehen përshtypjet dhe iu përgjigjen pyetjeve.
- Reflektim i përbashkët me tërë klasën; Shtysat dhe pyetjet në lidhje me këtë:
  - Çfarë ndjenjash ju shoqërojnë në këtë punë?
  - Ku ka ngjashmëri dhe dallime në jetëshkrimet tuaja?
  - Kujt i atribuohen kjo ngjashmëri dhe dallimet? (aspekti gjinor, mosha, sfondi i emigrimit etj.)
  - Cilat ngjarje shënohen si veçanërisht negative/pozitive? Pse?
  - Si qëndrojnë e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja për secilin/en së bashku?

# 2.6 Unë shkruaj historinë!

## Qëllimi

*N janë të ndërgjegjshëm për resurset, të cilat rrjedhin nga historia e tyre e migrimit dhe aftësitë e tyre dykulturore-dygyjuhësore. Ata tregojnë se si mund t'i përdorin dhe t'i shfrytëzojnë këto burime në jetën e përditshme.*

kl. 1-9

30-60 min.



Materiali:  
shirita letre, letër poster.

Udhëzim:

Skenat, që përmenden dhe tregohen këtu, mund të përdoren gjithashtu për luajtjen e roleve. Në fund të çdo skene, vëzhguesit/et u japin lojtarëve/eve përshtypjet e tyre për aspektin e përmbajtjes dhe mënyrës së paraqitjes.

Rrjedha:

- Si hyrje M jep një shembull se si N mund t'i përdorin si resurse aftësitë dykulturore-dygyjuhësore, të cilat i disponojnë për shkak të biografisë së migrimit. Episode të tjera vijnë nga N. Shembuj: «Unë e kam ndihmuar dikë në aeroport për t'u marrë vesh me policinë, sepse unë mund të përktheja», «Unë kam pasur besim për të marrë pjesë në një diskutim midis dy njerëzve në lidhje me besimin tim fetar, sepse unë i përkas kësaj feje»; «Unë kam ndërhyrë kur kam vënë re një keqkuptim mes dy njerëzve të kulturave të ndryshme dhe munda të ndihmoj për ta sqaruar atë.».
- Më pas, N kujtohen për përvojat personale (ose përvojat e njerëzve nga mjedisi i tyre) dhe i shkruajnë ato në shirita letre.
- Me tërë klasën (në rreth) ose në dy ose tri grupe nivelesh lexohen para të tjerëve dhe komentohen shiritat e letrave. Ata do të ngjiten në një poster me emërtimin «Resurset e mia të migracionit» dhe ndoshta plotësohen nga shiritat tjerë të letrës. Shembuj: «Unë flas më shumë se një gjuhë, kështu që unë mund të ndërmjetësoj», «Unë mund të komunikoj me njerëz nga të dy vendet», «Unë kam disa vendbanime dhe kam miq këtu dhe atje», «Unë mund të festoj dy herë: festat e kulturës sime të pre-jardhjes dhe të besimit fetar dhe festat të cilat festohen këtu!», «Unë di historira, që nuk i dinë të gjithë» etj.
- Thellimi/vazhdimi (i përshtatshëm si detyrë shtëpie): «Portrete personale fotografike»: N duhet të fotografohen me telefonat e tyre në dhjetë vende të rëndësishme për ta. Në bazë të këtyre fotografive do të dokumentohen vendet e identifikimit dhe do të kristalizohen burimet, që do të bëhen të dukshme me anë të posterave.

# 2.7 Tri ide për ditët e projektit

Vërejtje paraprake:

Sugjerimet e mëposhtme marrin më shumë kohë dhe janë veçanërisht të përshtatshme, para së gjithash, për ditët e projektit. Ditët e projektit ose projektet ditore në MGJP, me dy ose tri orë në javë, tradicionalisht nuk zhvillohen fare. Megjithatë, idetë e mëposhtme janë të përsosura për bashkëpunim mes MGJP dhe mësimit të rregullt, ose në mes të grupeve të ndryshme të MGJP, qoftë në kontekstin e ditëve të veçanta të projektit, qoftë si ditë brenda një jave të projektit të shkollës përkatëse. Një tjetër kontekst për sugjerimet e mëposhtme janë pushimet e verës ose kurset verore, të cilat i ofrojnë disa bartës të MGJP.

## Qëllimi

*Temat e tilla si migrimi, diversiteti kulturor dhe gjuhësor (shih gjithashtu Njësia 3) janë të dyja shumë aktuale, si në vendet e prejardhjes, ashtu edhe në vendet mikpritëse. Zotërimi i vetëdijes, ndjeshmërisë dhe kompetencës në lidhje me këto tema është një synim mbizotërues dhe pa dyshim i rëndësishëm së lartë. Sugjerimet e mëposhtme tregojnë për këtë qasje të ndryshme.*

### 2.7a Historia e migrimit e familjes sime



Rrjedha:

- Projekti është i ndarë në të paktën dy faza (p.sh. në dy gjysmëditë të një jave projekti). Në fazën e parë, do të sistemohen pyetjet në lidhje me historinë e migrimit të familjes dhe do të përpilohet një pyetësor (shembujt për pyetjet shih më poshtë). Këtyre pyetjeve N u përgjigjen vetë në një punë individuale. Pastaj do të bëhet një shkëmbim në grupe të vogla.
  - Si detyrë shtëpie do të intervistohen prindërit ose gjyshërit apo të afërmit e tjerë. Përgjigjet do të regjistrohen në formë të shkruar dhe do të sillen në shkollë.
  - Në fazën e dytë rezultatet do të dokumentohen dhe vlerësohen. Për këtë qëllim mund të bëhen pllakate dhe pastaj të prezantohen, diskutohen dhe të krahasohen. Aspekte të rëndësishme: shkaqet e migracionit; paraqitja në një hartë të botës apo të Evropës; ndikimi i migrimit mbi familjen në aspektin ekonomik, kulturor dhe gjuhësor. Pllakatet mund të plotësohen me fotografi, objekte, grafika.
- 
- Shembujt të pyetjeve të intervistës:
    - Pyetjet në lidhje me sfondin personal të emigrimit (Ku ke lindur? Kur ke ardhur këtu? Sa vjeç ishe në atë kohë? Çfarë kontaktesh ke me të afërmit e tu? Si kujdesesh për këto kontakte? Si flet ti me prindërit e tu, vëllezërit dhe motrat e tua? etj.
    - Pyetjet për historinë e migrimit të prindërve/gjyshërve/fqinjëve (Ku keni lindur, ku jetoni tani? Pse keni ardhur këtu? Si flitet në familjen tënde për vendin e prindërve të tu, gjyshërve të tu? Çfarë festash të veçanta festoni në familje; kush merr pjesë në ato festa; çfarë halet? Në cilat grupe, shoqata, institucione ndjeheni se i përkisni? Cilat kontakte i mbani në vendin e prejardhjes dhe në vendin e emigracionit? Si e vlerësoni nga perspektiva e sotme vendimin tuaj për të emigruar? Cilat ëndrra dhe dëshira janë përmbushur, cilat jo?)

## 2.7b

### Shumëllojshmëria kulturore në lagjen tonë

kl. 4–9

Dita e projektit



Rrjedha:

- M do të informojë klasën: Në bazë të intervistave dhe një reportazhi në lagje, do të bëhet ndërgjegjësimi dhe reflektimi ndaj diversitetit kulturor dhe shkaqeve të migrimit në një kontekst më të gjerë se sa vetëm në familjen personale dhe grupin etnik. Projektin e çon më tutje propozimi 2.7a në mënyrën më optimale.
- Me tërë klasën ose në grupe do të formulohen pyetjet për intervistat me fqinjët/et dhe njerëzit e tjerë të lagjes. Si bazë shërbejnë pyetjet nga intervistat në projektin 2.7a. Ato do të plotësohen me të dhënat mbi vendin e prejardhjes, gjuhën, kohën e migrimit.
- Vlerësimi kryhet në mënyrë analoge me atë në projektin 2.7a, shih më lart.

## 2.7c

### Emigrimi ka të bëjë me ne të gjithë!

kl. 4–9

Dita e projektit



Rrjedha:

- Si një vazhdimësi autentike e intervistave nga projekti 2.7b do të ftohen në mësim migrantë/e nga rrethe të ndryshme kulturore (p.sh., të njohurit apo fqinjët/et nga mjedisi i M, ose N) për të treguar historinë e tyre të emigrimit. Paraprakisht M mund të diskutojë me N fazat më të rëndësishme dhe aspektet e biografisë së emigrimit dhe të hartojë një model, që mund të përmbajë pikat si p.sh., prejardhja, arsyet për emigrim, udhëtimi, ardhja, situata e tanishme, dëshirat.
- N mbajnë shënime gjatë të rrëfyerit në modelin e tyre. Mbi gjendjen e vendit gjatë migrimit mund të bëhet edhe një hulumtim si detyrë shtëpie, ose mund të lexohet një tekst-bazë.
- Diskutim përfundimtar për pikat e përmendura dhe për krahasim me situatat personale të migrimit dhe motivet.

**Njësia 3:**  
**Gjuhët tona – ne flasim më  
shumë se një gjuhë**





Një objektiv parësor i arsimit ndërkulturor, integruar apo gjithëpërfshirës është që njerëzit të orientohen në kontekste multikulturore dhe të ndërveprojnë pa paragjykime dhe me sukses me njerëzit nga kulturat e tjera. Ata duhet sigurisht të mbajnë edhe identitetin e tyre dhe të jenë në gjendje ta zhvillojnë atë pa trysinë për t'u asimiluar.

Ana gjuhësore e shoqërive multikulturore është shumëgjuhësia, ashtu si kjo është një realitet në vendet e emigracionit në çdo shkollë, në çdo klasë. Të kundruarit e shumëgjuhësisë me interesim dhe çiltërsi dhe, në të njëjtën kohë, të vlerësuarit dhe të kujdesurit për gjuhën personale (përkatësisht gjuhët dhe dialektet e veta), numërohet si një prej aftësive më të rëndësishme dhe të domosdoshme ndërkulturore.

Mësimi në gjuhën e prejardhjes këtu mund dhe duhet të japë ndihmesën e vet. E vetëkutuëshme që qendra e tij është gjuha e parë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se potencialet dhe burimet e tjera, të cilat nxënësit/et i kanë, të lihen pas dore, apo të mos merren parasysh. (Gjithashtu kjo natyrisht, aq më pak, nuk duhet të ndodhë në klasat e rregullta. Edhe mësimi i rregullt duhet që këtë potencial ta kapë dhe ta përdorë duke iu përshtatur nxënësve/eve dhe orientimit në mjedisin jetësor.)

Nëntë propozimet e mëposhtme tregojnë, në mënyrë të thjeshtë, se si dygjuhësia ose shumëgjuhësia e nxënësve/eve dhe shumëgjuhësia e shoqërisë mund të çojë në sekuenca emocionuese të mësimdhënies. Këto projekte janë edhe më motivuese, kur ato mund të drejtohen menjëherë tek potencialet e pranishme dhe përvojat e nxënësve/eve të MGJP. Në shumë raste, me to gërshetohen mundësi krijuese. Dhe, më në fund, pikërisht në krahasim me gjuhët e tjera shpesh mund të dallohen edhe veçantitë dhe veçoritë e gjuhës së vet. Se cila pjesë e kompetencës do të jetë në plan të parë (kompetenca e perceptimit, reflektimit, e ndërveprimit), tregohet në pasqyrën në fund të librit. Kategorizimet për klasat dhe nivelet janë shumë të gjera; shumica e propozimeve mund të zbatohen me përshtatje përkatëse në nivelet specifike.

Një udhëzim i rëndësishëm në fund: Për sa i përket gjuhës së parë, në MGJP në plan të parë qëndron përkrahja e kompetencave letrare (mësimi i gjuhës standarde, i të lexuarit dhe i të shkruarit të saj). Kjo është bindëse për shkak se shumë nxënës/e gjuhën e parë në shtëpinë prindërore e praktikojnë vetëm në dialekt dhe nganjëherë vetëm me një leksik shumë të kufizuar. Tek projektet e gjuhës në këtë kapitull, megjithatë, duhet domosdoshmërisht të përfshihen edhe dialektet (në gjuhën e parë dhe në atë të vendit mikpritës), dhe në mënyrë të ngjajshme edhe kodet e grupeve të veçanta dhe format e përdorimit të gjuhës.

# 3.1 Tiparet e gjuhëve

## Qëllimi

Ky projekt i vogël i përshtatshëm për të gjitha moshat, ndihmon për të qenë i vetëdijshëm në mënyrë krijuese për mjedisin personal gjuhësor dhe për të reflektuar mbi marrëdhënien personale me gjuhët e ndryshme (kompetenca e reflektimit). Në të njëjtën kohë kjo çon edhe në diskutime të frytshme dhe informative edhe për M.

kl. 1–9

30 min.



Materiali:

Për çdo fëmijë një fletë A-4 me skicimin e një djali apo vajze; Lapsat me ngjyra.

Udhëzim:

Projekti është i përshtatshëm në mënyrë ideale si hyrje në përpunimin e temave mbi biografitë gjuhësore, siç është paraqitur në 3.5.

Rrjedha:

- M bën një hyrje të kujdesshme, por jo shumë të gjatë, në një çështje: Ne të gjithë rritemi në dhe mes gjuhëve të ndryshme: Gjuha jonë personale, e folur në shkollë, ajo e fqinjve, anglishtja nga reklammat dhe skena muzikore etj. Si gjuhë duhet të vlejë edhe dialekti dhe varianti standard i gjuhës së parë dhe ai i vendit mikpritës. Disa prej këtyre gjuhëve na pëlqejnë shumë, të tjerat jo edhe aq. Këto marrëdhënie të ndryshme mund t'i paraqesim mirë nëpërmjet asaj që gjuhët veç e veç të caktohen në pjesë të caktuara të trupit.
- Çdo fëmijë merr një fletë me skicimin e një djali apo vajze. Detyra: të merren lapsat me ngjyra, lart në fletë të bëhet një legjendë e ngjyrave (p.sh. e kuqe = gjuha amtare në dialekt; e kaltërt = gjuha amtare në variantin standard, e gjelbër = gjuha (dialekti) e vendit të emigrimit, ..., ngjyrë vjollce = tamilishtja si gjuhë e një familje fqinje etj.).



- Në skicimin gjuhësor të pjesës në të cilën përshtatet një gjuhë e caktuar, të ngjyroset me ngjyrën përkatëse (për shembull gjuha amtare/dialekti te zemra; gjuha e shkollës, frëngjishtja, te duart, për shkak se ajo mund të më ndihmojë ndonjëherë në punë etj). Disa nga gjuhët e mjedisit nuk do të jenë në skicë, por rreth tyre (p.sh. gjuhën e familjes fqinje, që unë shpesh e dëgjoj, por ndaj së cilës ndoshta nuk kam marrëdhënie të veçantë). E rëndësishme: Fëmijëve të mos u bëhen propozime apo rregulla tepër konkrete! Plotësimi i skicës bëhet nëpërmjet punës individuale dhe qetësisë së plotë në klasë.
- Pas rreth 10–15 minutash N ulen së bashku (e tërë klasa ose në tre runde) dhe shpjegojnë ilustrimet e tyre: cilën gjuhë dhe pse e kam caktuar në këtë vend, cila gjuhë çfarë rëndësie ka për mua, pse është kjo kështu?

Variante:

Vetëportret ose profili personal me qendër gjuhët (gjuha ime e parë, cilat gjuhë të tjera i di, çfarë gjuhësh fliten në mjedisin ku jetoj unë etj.)

Udhëzime për literaturën

Informacione të thelluara nga «zbuluesi» i portretizimit të gjuhëve, prof. Hans-Jürgen Krumm nga Viena i gjeni në vjeggzën [http://www.akdaf.ch/html/rundbrief/rbpdfs/61\\_Mehrsprachigkeit\\_Sprachenportraits.pdf](http://www.akdaf.ch/html/rundbrief/rbpdfs/61_Mehrsprachigkeit_Sprachenportraits.pdf)

## 3.2 Projekte dy-ose shumëgjuhësore

### Qëllimi

Në projektet dy ose shumëgjuhësore me shkrim nxënësitet e MGJP bëhen të vetëdijshëm për burimet dhe mundësitë tyre. Duke u nisur nga gjuha e parë, krijohen raste autentike në të cilat mund të përkrahet kompetenca në të shkruar. Motivimi i ndihmon edhe krijimi i produkteve tërheqëse.

kl. 3–9

30–60 min.



Materiali:

Në varësi të projektit.

Udhëzim:

- Në qendër të MGJP qëndron realizimi i projektit në gjuhën e parë (edhe pse disa N ndihen më të sigurt në gjuhën e vendit mikpritës). Versioni në gjuhën e dytë apo gjuhën e vendit mikpritës ndodh në një hap të dytë.
- Bashkëpunimi me mësimin e rregullt është veçanërisht i frytshëm dhe i dobishëm në këto projekte. Tekstet dygjuhëshe, që krijohen këtu janë ideale për zgjerime shumëgjuhësore; krahaso këtu idetë nr. 21 dhe 22 në fletoren «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë».

Rrjedha:

- Klasa njoftohet për planifikimin e një projekti dygjuhësor ose shumëgjuhësor; marrëveshja e përbashkët në lidhje me temën, llojin e tekstit dhe produktin që do të krijohet aty. N duhet të kenë kuptuar se bëhet fjalë për përdorimin e aftësive të tyre në dy gjuhë.
- Temat e mundshme dhe produktet:
  - Niveli i ulët: modelimi i një libri të ilustruar dygjuhësh (poshtë teksti në gjuhën e parë, lart në gjuhën e dytë). Ilustrimet bëhen ose nga vetë fëmijët (për një tregim që e gjejnë vetë ata ose nga një tregim që ua ka lexuar M), ose M ua jep modelin e gatshëm për ta ngjitur në fletore (p.sh. një tregim të ilustruar). Variante: Të modelohet një «mini-libër»; krahaso broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë», nr 21.2 dhe 22.4; Vjeggza: <http://www.minibooks.ch/>.
  - Niveli i ulët dhe i mesëm: Poezi dygjuhëshe për një temë apo një formë letrare (p.sh. «poezi njëmbëdhjetëshe», shih broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë», Nr 21.1). Tekstet e krijuara pastaj mund të modelohen bukur dhe në letër me ngjyrë të lidhen në një libërth.
  - Niveli i mesëm: modelimi i një libri-aventurë dygjuhësh, krahaso broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë», Nr 21.2.
  - Niveli i mesëm dhe i lartë: Përmbledhje dygjuhëshe (receta kuzhine, receta artizanale, shaka, gjëgjëza, etj). Të mblidhen në një fletore ose dosje; eventualisht të shumëzohet dhe të dekorohet.

- Niveli i mesëm dhe i lartë: Modelimi i kopertinave të një libri dhe të tekstit të ballinës (ose dygjuhësor ose krahas në gjuhën e parë dhe në gjuhën e shkollës); krahaso: <http://www.sikjm.ch/literale-foerderung/abgeschlossene-projekte/mein-buchumschlag/> dhe <http://www.sikjm.ch/medias/sikjm/literale-foerderung/projekte/mein-buchumschlag-di-daktische-anregungen.pdf>.
- Niveli i mesëm dhe i lartë: modelimi i një «romani fotografish» dygjuhësh ose shumëgjuhësh me fotot e bëra vetë dhe me fluskat e fjalëve. Përpunimi bëhet më së miri në kompjuter. Shih. Broshura «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e tyre të parë», nr. 22.3.
- Niveli i mesëm dhe i lartë: Gazetë dygjuhëshe e nxënësve/eve (Gazetë muri, Gazeta e lidhur në format A4, gazetë elektronike).

## 3.3 Tema biografike gjuhësore

### Qëllimi

*Ballafaqimi me të rriturit në dhe mes dy gjuhëve forcon kompetencën e reflektimit dhe njohuritë për veçoritë e biografisë së vet dhe kompetencës personale. Tema është tërheqëse dhe ndihmuese nëse lidhet drejtpërdrejt me përvojat dhe kujtimet personale.*

kl. 2–9

30–45 min.



Materiali:  
Varësisht nga lloji i zbatimit  
(A-2-letër për poster).

Udhëzime:

- Në të shumtën ekzistojnë si gjuha e parë ashtu edhe ato të vendit mikpritës në varantet dialektore dhe në formën standarde. Natyrisht, të gjitha duhet të tematizohen. (Më së shumti vështirësi kanë nxënësit/et me variantin standard të gjuhës së parë.)
- Tema mund të trajtohet për çështje të ndryshme, duke ia përshtatur moshës. Është mjaft e mundur që grupet e niveleve të ndryshme të punojnë paralelisht për çështje të ndryshme dhe në vazhdim t'i paraqesin rezultatet e tyre.
- Në raste normale projekti do të shpërndahet në dy javë (hyrja në javën e parë, zhvillimi në të dytën). Një pikënisje të mirë përbëjnë «skicat gjuhësore», shih më lart 3.2.

Rrjedha:

- M i informon N në lidhje me projektin, formulon pyetjet e sakta (ndoshta për secilën grup-moshë një pyetje tjetër, shih më lart) dhe jep udhëzime të qarta për punë të mëtejshme (p.sh. për të marrë informacionet e kërkuara deri në javën e ardhshme, si dhe për t'i sjellë shënimet përkatëse). Një listë e pyetjeve të mundshme mund të gjendet më poshtë.
- Në javën tjetër rezultatet e detyrave të dhëna do të sistemohen, eventualisht të përmbledhen në formë të shkruar në një poster dhe të paraqiten në klasë. Në varësi të boshtit mund të përfundojë me një tekst të shkruar, ose me një diskutim në të cilin N i pasqyrojnë përvojat e tyre të cilat ata i kanë fituar në këtë projekt.
- Pyetje të mundshme:
  - Për të gjitha nivelet: Fjalët dhe fjalitë e mia të para në gjuhën e parë dhe të dytë (të pyetet edhe në shtëpi!); gabimet qesharake dhe aksidentale në gjuhën e parë dhe të dytë (e kuptuar gabimisht dhe e zbatuar); njerëz të rëndësishëm gjatë të mësuarit të gjuhës së parë dhe të dytë.

- Niveli i mesëm dhe i lartë: Cilat ishin vështirësitë e mia të veçanta gjatë të mësuarit të gjuhës së dytë? Çfarë mësoja dhe si, cilat strategji i kisha/i kam? Çfarë më sjell ende vështirësi dhe si mund ta zotëroj atë? Variante: keqkuptime qesharake të paraqiten si skeç në skenë.
- Niveli i mesëm dhe i lartë: Çfarë di unë mirë në gjuhën time të parë dhe në cilat fusha kam vështirësi?
- Niveli i mesëm dhe i lartë: Dialekti dhe gjuha standarde në gjuhën e parë dhe të dytë: Ku e përdor unë dhe në çfarë forme; si është marrëdhënia ime emocionale me të dy varietetet; çfarë ndihmon për përvetësimin e gjuhës standarde (çka është e dobishme, sidomos edhe në gjuhën e parë)?
- Niveli i mesëm dhe i lartë: Të rriturit në dhe me dy gjuhë: Cilat janë përparësitë, por edhe problemet në raport me të rriturit në njëgjuhësi? – A do t'i rrit fëmijët e mi gjithashtu dygjuhësh, pse (jo)?
- Niveli i mesëm dhe i lartë: Përvojat e prindërve apo gjyshërve gjatë të shpërngulurit në një rajon të ri gjuhësor: Si u ndjetë, çfarë vështirësish kishit, si u ballafaquat me to? Për këtë qëllim mund edhe të përgatiten pyetjet kryesore për një intervistë dhe pjesë të saj të incizohen në CD.
- Niveli i lartë: Gjuhët e ndryshme kanë shpesh edhe një prestigj të ndryshëm, të lartë. Si është kjo me gjuhën tonë të parë; Çfarë përvojash kam bërë këtu?

## 3.4 Përdorimi i mediave elektronike në gjuhë të ndryshme

### Qëllimi

*Kompetenca për mediat, veçanërisht kompetenca në përdorimin e mediave elektronike numërohet si një nga aftësitë kryesore në botën e sotme. Në mjedisin shumëgjuhësh, kjo aftësi duhet të zhvillohet dhe zgjerohet natyrisht në lidhje me më shumë se një gjuhë. MGJP mund dhe duhet të përdoren këtu raste të shumëllojshme.*

kl. 5–9

10–90 min.



Materiali:  
kompjutera me qasje në internet  
(në shkollë ose në shtëpi),  
telefoni celular/smartphone.

#### Udhëzime:

- Mediat elektronike, që mundësojnë të përdoren në shkollë edhe në gjuhë të ndryshme, përfshijnë para së gjithash këto: kompjuteri (përpunimi i tekstit dhe modelimi; interneti për të mbledhur informacione, e-mail; rrjetet sociale (Facebook, chatrooms etj.) dhe Skype për kontakte me shkrim dhe me gojë dhe informata) telefoni celular për sms, smartphone për funksione në formën e kompjuterit.
- Në qendër të MGJP qëndron përdorimi i mediave elektronike në gjuhën e prejardhjes; përveç kësaj, këto media lejojnë të përdoren edhe në kuadër të projekteve të tjera (në këtë kapitull, për shembull, për propozimet 3.3–3.6).
- Tek dhënia e nocioneve kërkuese në internet, drejtshkrimi korrekt është me shumë rëndësi. Në rast të pasigurive duhet, së pari, të konsultohet një fjalor apo një makinë përkthimi.
- Në qoftë se nuk ka kompjutera për shfrytëzim në shkollë, detyrat duhet të jepen në atë mënyrë që të mund të përpunohen edhe në shtëpi. Në mënyrë që çdo fëmijë të ketë qasje në një kompjuter, ndoshta duhet të formohen ekipet dyshe.

Mundësitë dhe shembuj të përdorimit:

- Krijimi i një teksti (poezi, tregim) ose i një libri në gjuhën e prejdardhjes në kompjuter (paraqitja e bukur, event. ilustrime, edhe pa internet e mundshme).
- Hyrje për N në përdorimin e makinave të rëndësishme të kërkimit ose burimeve të informacionit në gjuhën e prejdardhjes (Wikipedia, etj); luajnë me disa shembuj.
- Marrja e informacioneve nga faqet e internetit në gjuhën e prejdardhjes (p.sh. për tema historike, të bujqësisë, të poezive / përrallave etj). Planifikimi i temës duhet të bëhet së bashku me N, rezultatet e kërkimeve në internet do të duhej të integroheshin si një material mësimor.
- Përdorimi i e-mail, skype, sms për marrjen e informacionit nga vendi i prejdardhjes (të afërmit, shokët/shoqet).
- Korespondencë me një klasë në vendin e prejdardhjes; krahaso më poshtë 3.6.
- Eksperimente me makineritë e përkthimit (p.sh. me «përkthyesin» e integruar të Google): të jepet një tekst i shkurtër në gjuhën e vendit mikpritës, për ta përkthyer në gjuhën e prejdardhjes: Çfarë është krijuar, çfarë gabimesh ka, si mund të shpjegohen etj. Të bëhet e njëjta në drejtim të kundërt.

## 3.5 Dialektet në gjuhën tonë dhe në gjuhët e tjera

### Qëllimi

*Në shumicën e gjuhëve ka përveç standardeve, apo varianteve të shkruara, edhe një numër variantesh dialektore, veçanërisht për përdorim gojor. Perceptimi i N lidhur me këtë duhet të forcohet si dhe të zgjerohen njohuritë dhe vetëdija e tyre gjuhësore.*

kl. 5–9

45 min.



Materiali:  
Ndoshta harta e vendit.

Rrjedha:

- Hyrja, p.sh. ashtu që M të fillojë mësimin në dialektin më të gjerë të mundshëm dhe të informojë se sot do të zhvillohet një orë mësimi në lëndën e gjuhës mbi një temë të veçantë. Për çfarë mund të bëhet fjalë?
- Diskutim: hamendësime të N, përvojat me dialektin apo dialektet në gjuhën e parë: Kush e përdor dialektin, kur dhe ku, cilat fjalë tipike në dialekt i dini (të shënohen në dërrasë të zezë) çfarë dallimesh dialektore ekzistojnë në mes rajoneve të ndryshme (të tregohen në hartën e vendit!); problemet në të kuptuar mes dialekteve të ndryshme etj.
- Detyrë për javën e ardhshme të sillen regjistrimet për dialektet (gjyshërit etj., ndoshta të incizohen nëpërmjet telefonit/skype). Ndoshta në dëgjuesat mund të gjenden prova për dëgjim në dialekt në internet (për shembull, italisht: <http://www.yougulp.it/dialetto/>): Të sillen dhe të lokalizohen në hartë vendet ku fliten të folmet dialektore.
- Vështrim në gjuhën standarde: çfarë e bën atë të ndryshojë nga dialektet, ku përdoret (për të shkruar, në lajmet televizive etj.). Ndoshta të shkruhet një tekst i shkurtër në gjuhën standarde dhe të krahasohet me dialektin. Çfarë është e vështirë në gjuhën standarde?
- Si është prestigji i dialektit në gjuhën tonë; ku dëgjohet ai; kush e përdor atë (ose jo)?

- Dialektet dhe gjuha standarde në vendin e emigracionit: çfarë dinë N për to; kur përdoret, cili variant; cili është prestigji i dialektit këtu?
- Diskutim: Marrëdhënia ime emocionale me dialektin dhe gjuhën standarde në gjuhën e parë dhe të dytë; Vlerësimi im për përdorimin praktik të dialektit dhe të gjuhës standarde.

## 3.6 Korrespondenca për çështjet ndërkulturore

### Qëllimi

*Pyetjet që lidhen me jetën në, me dhe në mes të kulturave janë veçanërisht aktuale për nxënësit e MGJP. Qëllimi i projektit «korrespondencë» është për t'i diskutuar këto çështje me njerëz nga kontekste të tjera dhe nëpërmjet kësaj për t'i zgjeruar pikëpamjet personale. Në të njëjtën kohë, projekti ndihmon për kompetencën në të shkruar dhe për kompetencën për mediat.*

kl. 5–9

45 min.



Rrjedha:

- Në bazë të një teme aktuale në kuadër të temës «Bashkëjetesa ndërkulturore» M i nxit N për të marrë pikëpamjet e njerëzve nga kontekstet e tjera dhe për t'u ballafaquar me to. Kjo duhet të ndodhë në formën e një korrespondence elektronike (e-mail, ndoshta SMS). Tema/çështje të mundshme: Përvoja personale me ksenofobinë të ne – pozita e «të huajve» në sistemin politik – pozita e MGJP në sistemin arsimor – pozita dhe prestigji i pakicave të tilla si p.sh.romët – diskutim në lidhje me debatin aktual politik.



- Me klasën zgjidhet një temë dhe diskutohen partnerët/et korrespondentë të mundshëm dhe kontekstet. Shembuj të korrespondencës me klasët: Një klasë e shkollës nga vendi i prejardhjes – një klasë e MGJP në një komunë tjetër të vendit mikpritës – një klasë MGJP në një vend tjetër të emigracionit – një klasë e MGJP nga një grup tjetër gjuhësor. (Tek vendosja e kontakteve përkatëse ndoshta mund të ndihmojë Ministria e Arsimit e vendit të prejardhjes.) Për korrespondenca individuale: të afërmit, miqtë, të njohurit brenda grupit ose nga grupet e tjera gjuhësore. Është emocionuese kur e njëjta çështje u shtrohet adresuesve/eve në kontekste të ndryshme. Sigurisht, mund t'u shkruhet edhe politikanëve/eve ose autoriteteve dhe të lutet që të japin pozicionimin e tyre.

- Do të ketë dakordim për kushtet paraprake për korrespondencën (p.sh. një numër çështjesh të përbashkëta), në mënyrë që rezultatet të jenë të krahasueshme.
- Në qoftë se kanë ardhur përgjigje të mjaftueshme, ato do të vlerësohen, grupohen, paraqiten (p.sh. në një poster) dhe diskutohen.

## 3.7 Përdorimi i gjuhës: i ndryshëm sipas kontekstit!

### Qëllimi

*Kompetenca në të vepruar dhe në komunikim parakupton që njeriu të sillet në atë mënyrë që, si në aspektin gjuhësor, por edhe me gjeste, mimikë, largësia gjatë të folurit, t'u përshtatet situatave përkatëse ose gërshetimeve sociale. Rregullat përkatëse janë kryesisht të pashkruara dhe kulturalisht të veçanta. Duke menduar rreth tyre dhe duke eksperimentuar me to, forcohen kompetencat sociale dhe komunikuese.*

kl. 3–9

20–45 min.



Rrjedha:

- Hyrjet e mundshme në temë:
  - Një pyetje nxitëse (p.sh.: Të drejtuarit me «ju» dhe «ti» në gjuhën tonë dhe në gjuhën e vendit ku jetojmë tani?).
  - Një episod nga një keqkuptim komunikues (ngatërrimi i ju/ti; distancë shumë e afërt me personin të cilit i drejtohesh, me zë të lartë, mënyrë tepër formale e përshëndetjes).
  - Një fillim i mirë mund të bëhet edhe kur M qëllimisht nuk e zbaton një rregull të pashkruar të komunikimit (përdorim i gjuhës tepër formal ose i çrregullt ndaj një nxënëseje; zë tepër i ulët ose tepër i lartë ...).
- Diskutim mbi çështjet e shtruar; Formimi i vetëdijes për normat e pashkruara, të cilat (përveç kuptimit gramatikor) duhet të respektohen për funksionimin e komunikimit.
- Eksperimente skenike me përdorimin e veçantë grupor të gjuhës dhe të elementeve jogjuhësore (kontakti trupor, volumi, gjestet, largësia e folësit etj): Çfarë «përshtatet» në komunikimin me shokët/shoqet – me autoritetet – me gjyshërit – me vëllezërit e motrat etj.? Çfarë do të ishte jo me vend; pse? Të mendohet edhe për përdorimin e dialektit dhe të gjuhës standarde.
- Krahasimi i normave në lidhje me ju/ti, vëllimi, distanca gjatë të folurit, kontakti fizik, dhënia/puthja e dorës gjatë përshëndetjes etj. në kulturën e prejardhjes dhe në vendin e emigracionit. Ku ka dallime të rëndësishme? Çfarë do t'i këshillonit patjetër dikujt që vjen i ri në një vend? (Ndoshta të shkruhet një check-listë.)
- Gjestet: Cilat gjeste në kulturën tonë të prejardhjes janë të rëndomta (ose tabu), e cilat në vendin ku jetojmë tani; cilat janë «ndërkombëtare»?



**Njësia 4:**  
**Komunikimi ndërkulturor –**  
**bashkërisht të mirëkuptohemi**



Kur komunikojmë, ne nuk shkëmbejmë vetëm informacione. Ne gjithmonë dërgojmë sinjale edhe për llojin e marrëdhënies që kemi me ata që janë përballë nesh. Përveç kësaj, stili ynë i komunikimit është – qoftë në përbajtje apo në nivelin e marrëdhënies – gjithmonë i ndikuar edhe kulturallisht. Kjo ka të bëjë, për shembull, me ngritjen e zërit, gjestet, afërsinë ose largësinë ndaj personit që kemi përballë, kontaktit trupor me bashkëbiseduesin, elementet «rituale» në fillim dhe në fund të komunikimit (pyetje në lidhje me shëndetin etj.), të biseduarit drejtpërdrejt me të cilin njeriu mund të paraqesë një shqetësim etj. Të gjitha këto aspekte janë kulturallisht të veçanta. Kjo nuk vihet re tek dikush brenda kulturës së vet, por në komunikimin ndërkulturor, d.m.th. në komunikimin me anëtarët e një kulture tjetër mund të çojë në keqinterpretime, pasiguri dhe keqkuptime. Përveç kësaj, në kontekstin e migracionit mund të ndihmojë edhe fakti se komunikimi këtu shpesh karakterizohet nga asimetritë e pushtetit dhe klishetë për të huajt. Edhe më e rëndësishme është një marrëdhënie e ndërgegjeshme, e ndjeshme diferencuese me komunikimin ndërkulturor, e cila ndihmon për një aftësi të lartë vepruese në kontekste multikulturore dhe multigjuhësore.

Një ndihmesë të rëndësishme në ndërtimin e kompetencës ndërkulturore të komunikimit mund dhe duhet ta japë edhe shkolla. Kjo vlen si për mësimin e rregullt në klasat heterogjene kulturore, ashtu dhe për mësimin në gjuhën e prejdardhjes në grupin homogjen në aspektin kulturor dhe gjuhësor. Kjo njësi jep nxitje dhe shembuj se si mund të zhvillohet ndjeshmërimi dhe kompetenca ndërkulturore në proceset e komunikimit në MGJP. Duke përdorur ushtrime të ndryshme, simulime dhe luajtje të roleve, nxënësit/et i perceptojnë proceset e komunikimit dhe reflektojnë sjelljen e tyre të komunikimit, mësojnë t'i njohin kurthet e komunikimit ndërkulturor dhe të zhvillojnë strategjitë për përmirësimin e sjelljes personale komunikuese. Sigurisht një rol të rëndësishëm luajnë edhe vetë burimet dhe përvojat e nxënësve/eve, të cilët për çdo ditë duhet të lëvizin në kultura dhe mes dy kulturave, të orientohen dhe të kuptohen.

# 4.1 Diçka nuk është në rregull këtu

## Qëllimi

*Të pasqyruarit e dallimeve të veçanta kulturore në sjelljen komunikuese është pjesë e rëndësishme e kompetencës ndërkulturore. Ushtrimi tregon se çfarë reagimesh, ndjenjash dhe kritikash mund të shfaqen, kur njerëzit nga kontekste të ndryshme kulturore, komunikojnë me gjuhë të ndryshme të trupit, shprehjeve të fytyrës, gjeste etj.*

kl. 3–9

30 min.



Materiali:

Udhëzimi për lojën si kopje (shih më poshtë).

Udhëzim:

Burimi: Interkulturelles Training. Materiale për ushtrime gjatë punës me të rinjtë në sport. Vjegza: [http://www.dsj.de/uploads/media/Interkulturelles\\_Lernen\\_2010.pdf](http://www.dsj.de/uploads/media/Interkulturelles_Lernen_2010.pdf).

Rrjedha:

- Do të formohen grupe dyshe (N1 dhe N2). Të gjithë N1 mbeten në klasë, të gjithë N2 shkojnë në një dhomë pranë klasës ose në korridor.
- N në klasë (grupi N1) duhet të gjejnë një temë për të cilën ata mund të flasim për disa minuta (përjetim, libër, film, pushime etj.). Çdo N1 më vonë do të bisedojë 5 minuta me një N2.
- M ia shpërndan grupit N2 fletën me udhëzimet e lojës dhe ua shpjegon atë derisa të gjithë t'i kenë kuptuar rregullat. Tani N2 kthehen në klasë.
- Bisedën e fillojnë, pjesëmarrësit që kanë qëndruar në klasë (grupi N1). Ajo merr rreth 5 minuta, pastaj M e ndërpret atë.
- Reflektim dhe diskutim me tërë klasën, së pari, për ushtrimin e mëparshëm: Çfarë ka ndodhur? Si ishte cilësia e bisedës? Si u ndjetë? Çfarë keni menduar për partnerin tuaj/partneren tuaj?
- Më pas bëhet përgjithësimi: A keni pasur edhe personalisht përvoja të ngjashme me stile të ndryshme të komunikimit ose i keni vërejtur në mjedisin tuaj? Çfarë janë dallimet në komunikim mes kulturës suaj të prejardhjes dhe kulturës së vendit ku jetoni tani (p.sh. në lidhje me përsëritjet, lartësinë e zërit, largësinë në mes të bashkëbiseduesve/eve, frazat etj.); krahaso gjithashtu më lart nr 3.7.

## Udhëzime për lojën


Nëse ti më pas do të bisedosh me një fëmijë tjetër, atëherë ndiqi rregullat 1, 4 dhe 5.

Te rregulla nr. 2 ti duhet të vendosësh nëse do të zgjedhësh 2a apo 2b, tek 3-shi gjithashtu.

- 1 Në fillim të bisedës përshëndete bashkëbiseduesin tënd/ bashkëbiseduesen tënde nëpërmjet asaj që ti i duartroket tri herë në dorë.



- 2 a) Në bisedë ti gjithnjë mban një largësi të vogël prej dy metrash.



- b) Në bisedë ti qëndron shumë afër personit përballë dhe herë pas here e vë dorën në krahun apo shpatullën e tij.



- 3 a) Gjatë bisedës ti gjithnjë shikon në tokë.



- b) Gjatë bisedës ti gjithnjë shikon jashtë fytyrës së bashkëbiseduesit.



- 4 Në qoftë se tjetri/tjetra flet, ti gjithnjë i mbyll sytë.



- 5 Para se të flasësh apo të përgjigjesh, ti gjithnjë pret dhjetë sekonda; mes fjalive bën gjithnjë pesë sekonda pauzë.



# 4.2 Me gjuhë të tregohet rruga

## Qëllimi

*Për bashkëjetesën dhe punën në kontekst multikulturor, komunikimi i qartë dhe efektiv është vendimtar. Ushtrimi 4.3 përkrah N që të komunikojnë qartë dhe në mënyrë efektive. Në të njëjtën kohë, ata mësojnë për të përshkruar problemet që mund të ndodhin gjatë komunikimit jo të saktë, dhe të mendojnë për strategjitë e zgjidhjeve.*

kl. 1–9

40 min.



Materiali:  
objektet që janë të  
vendosura në klasë.

Udhëzim:

Burimi për 4.2, 4.3 und 4.7: Schilling, Dianne (1993): Miteinander klarkommen. Toleranz, Respekt und Kooperation trainieren. Mülheim an der Ruhr: Verlag an der Ruhr..

Rrjedha:

- M i fton N pa shpjegime të mëtejshme për të ndihmuar në ndërtimin e një piste avioni. Me ndihmën e karrigeve, bankave etj., do të ndërtohet një pistë prej 6–8 metrash e gjatë dhe 1,5–2 m e gjerë. Në vazhdim do të shpërndahen në pistë 6–10 objekte (libra, letra, stilolapsa, etj).
- Tani M pyet se kush dëshiron të luajë rolin e pilotit/ pilotes, për ta zbritur avionin e tij në pistë, dhe kush dëshiron të jetë një kontrollues avioni, i cili është i ulur në dhomën imagjinare të kontrollit të aeroportit, dhe i jep udhëzime pilotit.
- Piloti dhe kontrolluesi vendosen në fundet e kundërta të aeroportit. M ia lidh sytë pilotit dhe i shpjegon se një stuhia ka filluar. Një rrufe e ka ndërprerë kontaktin valor të avionit dhe kullës së kontrollit në mënyrë të njëanshme: Piloti mund të dëgjojë ende kontrolluesin, por nuk mund t'i dërgojë më atij sinjale. Për më tepër, stuhia ka shkatërruar pistën; kudo janë shpërndarë sende. Piloti tani duhet të përpiqet që avionin ta zbresë në tokë në mënyrë të sigurtë, pa e dëmtuar atë. Duke qenë se ai nuk sheh asgjë, duhet të mbështetet plotësisht në udhëzimet e kontrolluesit. Nëse piloti ndesh në një prej objekteve në pistë, avioni është i humbur.
- Disa ekipe të kontrollorëve dhe pilotët përpiqen që avionin ta ulin në tokë në mënyrë të sigurtë. Pas çdo përpjekjeje do të diskutohen shkurtimisht vështirësitë, që janë shfaqur atje.
- Hyrje për diskutimin përfundimtar me tërë klasën: Si janë ndjerë pilotët/ pilotet? Si u përpoqën ata që ta kompensojnë «verbërinë» e tyre? Si janë ndjerë kontrolluesit/kotrollueset? Çfarë kanë bërë për t'i udhëhequr pilotët/et sa më saktësisht të jetë e mundur?  
Transferi: A keni përjetuar ju vetë situata të tilla dhe a ju kanë ardhur në mendje formulime mundësisht sa më të sakta ose udhëzime? Çfarë lloj situatash të kësaj natyre mund të jepen në kontekstin e kulturave dhe gjuhëve të ndryshme?  
Përgjithësim: Si mund të përcjellim mesazhe të qarta dhe të sakta? Sa është e rëndësishme gjuha në komunikim? Cilat elemente të tjera luajnë rol në komunikimin dhe mund të ndihmojnë për ta përmirësuar atë?

# 4.3 Të dëgjuarit aktiv

## Qëllimi

*Ushtrimi i përkrah N në të dëgjuarit aktiv. Kjo është një pjesë e rëndësishme e komunikimit dhe e kompetencës vepruese ndërkulturore. Bazuar në një ushtrim simulimi, do të zgjohet interesimi dhe ndërgjegjësimi i N për rolin e tyre si dëgjues/e në komunikimin ndërkulturore.*

kl. 4–9

40 min.



Materiali:

Kopjet e fletës së punës  
«Si dëgjuese e mirë/dëgjues i mirë ...»  
(shih më poshtë).

Rrjedha:

- M pyet N se çfarë kuptojnë me shprehjen komunikim dhe mbledh shembuj të situatave të komunikimit. Ai vizaton një grafik të thjeshtë (dërguesi ↔ marrësi) në tabelë dhe shpjegon se: «komunikimin ne mund ta përfytyrojmë si ping-pong ndërmjet dy njerëzve – dërguesit dhe marrësit. Nëse duan të kuptohen mirë, ata duhet mundësisht të komunikojnë pa pengesa. Kjo do të thotë se dërguesi e formulon mesazhin e tij sa më saktë që të jetë e mundur. Shpesh mesazhi me fjalë është i shoqëruar nga sinjale joverbale, si për shembull, duke qeshur, duke rrudhur ballin ose me gjeste. Por, për një komunikim të suksesshëm do të thotë gjithashtu që marrësi ose marrësja duhet të dëgjojë mirë dhe që mesazhi të mos keqinterpretohet.
- Pastaj idetë do të mblidhen dhe do të shënohen në dërrasë të zeze si një marrës i mirë tregon se ai është i interesuar për mesazhet e dërguesit dhe vërtet i dëgjon. Pastaj M e shpërndan fletën e punës, i diskuton propozimet e dhëna dhe ndoshta i plotëson ato.
- Do të formohen grupet treshe për të ushtruar të dëgjuarit aktiv. Në raundin e parë N1 është dërguesi dhe N2 është marrësi, respektivisht dëgjuesi aktiv. N3 duhet të vëzhgojë N2 gjatë të dëgjuarit dhe pastaj të reflektojë përshtypjet e tij në grup. Janë tri raunde, ashtu që secili/a të marrë njëherë secilin rol. Për dhënësit M propozon tema të tilla si p.sh.: «Kur kisha nevojë për ndihmë», «Çfarë dua unë të bëj më mirë», «Një problem që unë dua ta zgjidh». Dërguesit zgjedhin një temë dhe mendojnë të bëjnë pauza gjatë të folurit, në mënyrë që marrësi të mund të përgjigjet. M jep sinjalin për fillimin; pas 3 minutash e përfundon raundin. Vëzhguesit kanë një minutë kohë për raportin e tyre. Pastaj rolet do të ndërrohen. Së fundmi, fleta e punës do të plotësohet nëpërmjet punës individuale.
- Reflektim dhe diskutim me tërë klasën: Si je ndjerë si dëgjues aktiv? Si e ndjeve veten si vëzhgues/e? Po kur ishe dërgues: Si je ndjerë gjatë asaj kohe kur dikush të ka dëgjuar i përqendruar? Kur ishe dëgjues aktiv: Çfarë ishte më e thjeshtë, çfarë më e vështirë? Çfarë ke mësuar si vëzhgues? Pse është e rëndësishme që të kesh të dëgjuar të mirë? Kujtoje një situatë në të cilën ti ke mundur të dëgjosh me kujdes! Trego një shembull, kur ti ishe krenar për veten, sepse për shkak të të dëgjuarit të mirë ke marrë komente të mira.

# A jam unë një dëgjuese e mirë/një dëgjues i mirë

Fletë pune për nxënësit/et

## Si dëgjues i mirë/si dëgjuese e mirë ...



- ... e shikon folësin/en;
- ... e shikoni atë në sy;
- ... je i relaksuar, por i vëmendshëm;
- ... dëgjon me vëmendje dhe mendoresh se çfarë do të thotë folësi/folësja;
- ... nuk e ndërpret dhe nuk lëviz andej kënde;
- ... përgjigjesh vetëm gjatë pauzave;
- ... përpiqesh ta ndiesh edhe ti atë që folësi/folësja ndien;
- ... pohon me krye, bën «hmmm» apo e përmbledh shkurtimisht në mënyrë që folësi/folësja ta dijë që ju e keni dëgjuar.

## Çfarë bën mirë gjatë të dëgjuarit?

---



---



---



---



---

## Cila është ana jo e fortë e jotja gjatë të dëgjuarit?

---



---



---



---



---

## Çfarë mund të bësh që të dëgjosh më mirë?

---



---



---



---



---



# 4.4 Për vizitë

## Qëllimi

*N luajnë në një lojë simuluese joverbale kontaktet mes njerëzve të huaj me pritjet e ndryshme. Nëpërmjet analizës së mëvonshme do të duhet të përkrahet kompetenca e tyre për reflektim dhe duhet të fitojnë përvoja të thelluara në komunikimin ndërkulturor.*

kl. 4–9

30–45 min.



Materiali:  
Udhëzime për mikpritësit  
dhe miqtë (shih më poshtë).

Udhëzim:


- Ndjeshmëria për komunikim joverbal mund të thellohet nëse N do të nxi-ten që ta vëzhgojnë vetëdijshëm veten ose dikë tjetër gjatë dy-tri javëve të ardhshme në situatat e komunikimit dhe të sjellin shembujt përkatës.
- Burimi: Trajnimi ndërkulturor (shih më lart tek 4.1).

Rrjedha:

- Do të formohen grupe dyshe. Njëri është mikpritësi/ja e njëri është mysafiri/ja. Të gjithë marrin udhëzimet për rolet për grupin e tyre (shih më poshtë). Për përgatitje mikpritësit/et rrinë në klasë, mysafirët shkojnë në dhomën tjetër, ose në korridor. Gjatë përgatitjes N duhet të mendohen dhe të provojnë se si mund t'i zbatojnë pikat nga fleta e punës, pa folur me zë.
- Pas rreth dhjetë minutash fillon takimi. Nuk duhet të flitet. Loja zgjatë dhjetë minuta. Pastaj M pyet disa çifte për të folur shkurtimisht për përvojat e tyre.
- Reflektim dhe diskutim me tërë klasën. Shtysa për këtë:
  - Çfarë ka shkuar mirë; pse? Çfarë ndjenjash shkaktonte kjo?
  - Çfarë nuk ka shkuar hiq mirë; pse? Çfarë ndjenjash shkaktonte kjo?
  - A mundën mysafirët ta deshifronin sjelljen e mikpritësve?
  - Çfarë shkaktohej kur pritjet e caktuara nuk plotësoheshin?
  - Me çfarë kanë të bëjnë pritjet?
  - Përgjithësim: Ku ndodhin në realitet situata të ngjashme me pritje të ndryshme? Çfarë keni përjetuar ju vetë në këtë drejtim, si jeni sjellë ju?
  - A dini ndonjë shembull të situatave me pritje të ndryshme, të cilat mund të kenë të bëjnë pikërisht me dallimet kulturore?



### Udhëzimet për rolet për mikpritësit/et



#### Sjellja e mikpritësit/es:

- Ata sinjalizojnë «po» përmes rrotullimit të syve.
- Ata sinjalizojnë «jo», përmes asaj që e zgjatin gjuhën.
- Nëse duan të tregojnë diçka, nuk e bëjnë këtë me dorë, por duke i shqitur sytë.


#### Pritjet e mikpritësve/eve për mysafirin/ en.

##### Ata duhet ...

- ... të zbatin këpucët.
- ... së pari t'i lajnë duart.
- ... t'ia dhurojnë mikpritësit/es një monedhë të vogël.
- ... t'ia sjellin mikpritësit/es një karrige.
- ... të ulen këmbëkryq pranë karriges.



### Udhëzimet për rolet për mysafirët



#### Pritjet e mysafirëve nga mikpritësi/ja.

##### Ata duhet ...

- ... të përkulen gjatë përshëndetjes.
- ... të tregojnë dhëmbët e tyre.
- ... të japin numrin e tyre të telefonit.
- ... mysafirit t'i jepet një send personal.
- ... të shkruajnë emrin e tyre në një copë letër.
- ... t'i ofrojnë mysafirit një karrige.

# 4.5 Si sillem unë në situata kritike

## Qëllimi

*N ballafaqohen në mjedisin jetësor vazhdimisht me situata kritike komunikimi e në kontekste ndërkulturore. Ky ushtrim i përkrah ata në rrokjen e kompetencës së nevojshme të veprimit dhe nxit ndjeshmërinë e tyre. Një qëllim tjetër i ushtrimit është që të tregohen strategjitë tipike gjinore.*

kl. 4–9

45 min.



Materiali:  
Pyetëtori, fletë letre të mëdha  
apo flipchart

Rrjedha:

- Hyrje në temë: Ne duam të shohim mendimin për mënyrën e të sjellurit në situatat kritike. Sqarimi i konceptit «situatë kritike» (p.sh. një situatë emocionalisht rënduese, konfliktet në familje dhe jashtë saj, armiqësitë). Mbledhja e shembujve konkret në klasë.
- M shpërndan pyetëtorin (shih më poshtë). N duhet të lexojnë në punë individuale çdo shprehje me kujdes dhe të mendohen se sa shpesh e tregojnë sjelljen në fjalë në situata kritike. Për këtë qëllim ata përdorin një shkallë prej 1 deri 4 (1 = Unë asnjëherë ose shumë rrallë sillem kështu; 2 = Unë ndonjëherë sillem kështu; 3 = shpesh; 4 = shumë shpesh).
- Pas rreth dhjetë minutash përgjigjet do të diskutohen me tërë klasën. Në mënyrë të veçantë do t'i kushtohet vëmendje ndonjë dallimi eventual mes djemve dhe vajzave.
- Së fundmi, klasa përpiket t'i ndajë strategjitë në kategori të mëdha (p.sh. të shmangjet problemi, të kërkojnë përkrahje, të adresohet problemi drejtpërdrejt, të tregohen emocionet negative). N i rregullojnë përgjigjet për të dokumentuar shpeshësinë e çdo strategjie dhe shpërndarjen në vajza dhe djem.

## Pyetësor: Si sillem unë në situata kritike?

Fletë pune për nxënësit/et


**1 = Unë nuk sillem kurrë  
kështu ose tepër rrallë**

**2 = Unë sillem  
nganjëherë kështu**

**3 = Unë sillem shpesh  
kështu**

**4 = Unë sillem shumë  
shpesh kështu**

Ju lutem kryqëzojeni atë që i përgjigjet



	1	2	3	4
Unë mbyllem në vetvete dhe dua të jem vetëm.				
Unë mendoj thjesht për diçka tjetër.				
Unë mundohem që stresin ta heq me anë të muzikës me zë të lartë, ushqimit, sportit.				
Unë përpiqem të shfryhem.				
Unë përpiqem ta harroj çështjen, duke u marrë me gjëra të tjera.				
Unë pyes dikë për ndihmë.				
Unë nuk mund të mendoj për asgjë tjetër, pos për problemin që kam.				
Unë zemërohem me vetveten. Sikur të mund të reagoja në mënyrë më lehtësuese (relaksuese)!				
Unë pres një grimë herë.				
Unë përpiqem të merrem menjëherë me problemin.				
Unë lë gjithçka ashtu siç është.				
Unë mendohem për rrugë të ndryshme që çojnë tek zgjidhja.				
Unë e mendoj secilin aspekt të problemit.				
Unë kërkoj solidarizim dhe përkrahje nga të tjerët.				
Unë e zgjidh problemin menjëherë.				
Unë mundohem ta zvarris problemin aq gjatë sa është e mundur.				

# 4.6 Atribuimet

## Qëllimi

*N thellojnë vetëdijen e tyre për ndikimin që kanë modelet e të menduarit kulturor dhe interpretues në komunikimin tonë. Si pikënisje merret ndonjë shembull i komunikimit të dështuar për shkak të atribuimeve të ndikuara kulturore.*

kl. 7–9

45 min.



Materiali:  
Kopjet e dialogut  
(shih më poshtë).

Udhëzim:

- Shembulli për dialog, natyrisht, mund të zëvendësohet me një shembull nga mjedisi personal jetësor. Por ky duhet të përpunohet njëjtë sikur shembulli ynë.
- Burimi: Sipas Triandis (1972) në Thomas Alexander u.a. (Hrsg.) (2003): Handbuch interkulturelle Kommunikation und Kooperation, Bd. 1. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht.

Rrjedha:

- M shpjegon, së pari, se çfarë është një atribum (Përkufizimi: Çdo gjë që njerëzit ia atribuojnë vetës dhe të tjerëve duke u nisur nga karakteristika të paragjyqimeve dhe hamendësimeve, p.sh., stereotipet etnike ose gjinore ose interpretime të tjera). Diskutim, se cilat nga këto përvoja relevante i kanë N.
- M informon se një dialog do të analizohet në dy nivele: 1. Në nivelin e asaj që ishte thënë në të vërtetë, 2. Në nivelin e interpretimeve të pashprehura dhetributeve. Konteksti: Bëhet fjalë për një dialog në mes mbikëqyrësit amerikan dhe punëtorit grek në një ndërmarrje ndërkombëtare. Veprimi zhvillohet në Greqi. Greku është prej një kohe të gjatë punëtor i suksesshëm. Amerikani u caktua kohët e fundit në krye të degës greke të kompanisë.
- N do të marrin një kopje të dialogut, ku pjesa e atribuimit (kolona djathtas) paraprakisht është palosur nga M dhe ende nuk mund të shikohet. Sipas roleve të dhëna, N lexojnë dialogun dhe pastaj diskutojnë në grupe të vogla arsyet e defekteve në komunikim.
- Pastaj ata e hapin fletën e palosur dhe lexojnë atribuimet në kolonën e djathtë. Ata diskutojnë në çifte se si u përfatuan këto atribuime.
- Reflektim dhe diskutim me tërë klasën:
  - Cilat janë arsyet kryesore për dështimin e komunikimit?
  - Cilat janë vlerat, sjelljet dhe pikëpamjet kulturore të veçanta që mund të kenë çuar peshë në sjelljen e dy burrave?
  - Cili mund të jetë hapi tjetër për një qasje konstruktive ndaj situatës? (Këtu duhet të mblidhen strategjitë e komunikimit ndërkulturor.)
  - Çfarë përvojash të tilla kanë bërë N vetë?

# Mbikëqyrësi i ri amerikan dhe punëtori i tij grek

Fletë pune «Dialogu» për nxënës/e

Sjellja/të thënat	Atribuimi: interpretimi/hamendësimi
<b>Amerikani:</b> Sa kohë të duhet ty për të përfunduar këtë raport?	<b>Amerikani:</b> <i>Unë e lut atë të marrë pjesë; unë dua ta angazhoj në marrjen e vendimit.</i>
<b>Greku:</b> Nuk e di. Sa kohë duhet të kem në shfrytëzim?	<b>Greku:</b> <i>Çka është kjo? Ai është shefi. Pse nuk më jep ai udhëzim të qartë?</i> <b>Amerikani:</b> <i>Ai nuk pranon të marrë përgjegjësi.</i>
<b>Amerikani:</b> Ti mund ta vlerësosh vetë se sa zgjatë kjo.	<b>Amerikani:</b> <i>Ai duhet të marrë përgjegjësi për veprimin e vet.</i> <b>Greku:</b> <i>Sa pa lidhje! Më mirë t'ia jap një përgjigje.</i>
<b>Greku:</b> mirë, dhjetë ditë.	<b>Amerikani:</b> <i>ai është i paaftë për ta vlerësuar saktësisht kohën. Ky vlerësim është krejt joreal.</i>
<b>Amerikani:</b> Më mirë 15. A pajtohesh për ta kryer punën në 15 ditë?	<b>Amerikani:</b> <i>Unë i ofroj atij një marrëveshje.</i> <b>Greku:</b> <i>Mirë, ai kërkon 15 ditë, ai është shefi.</i>
Në të vërtetë për raportin duheshin 30 ditë pune. Pra, greku punoi ditë e natë dhe në fund të ditës së 15-të ai kishte nevojë edhe për një ditë tjetër.	
<b>Amerikani:</b> Ku është raporti?	<b>Amerikani:</b> <i>Unë kontrolloj që ai të respektojë marrëveshjen.</i> <b>Greku:</b> <i>Ai do të ketë raportin.</i>
<b>Greku:</b> Ai do të jetë gati nesër.	<b>Të dy:</b> <i>Raporti ende nuk është gati.</i>
<b>Amerikani:</b> Por ne jemi marrë vesh që ai të jetë sot i përfunduar!	<b>Amerikani:</b> <i>Unë duhet ta mësoj këtë që t'i respektojë marrëveshjet.</i> <b>Greku:</b> <i>Ky shef budalla, jokompetent! Jo vetëm që më ka dhënë udhëzime të gabuara, por edhe nuk e çmon një herë që unë një punë të një 30-ditëshi e përfundoj për 16 ditë.</i>
Greku ia jep përmbimin. Amerikani është i befusuar.	
	<b>Greku:</b> <i>Për një njeri të tillë unë nuk mund të punoj.</i>

# 4.7 Çka e pengon komunikimin

## Qëllimi

*N e përjetojnë dhe e përshkruajnë se nga se mund të dëmtohet komunikimi dhe se si mund të veprojnë në situata të vështira të komunikimit. Ata ndërtojnë strategjitë dhe zgjerojnë kompetencat e tyre komunikuese.*

kl. 7–9

45–60 min.



Materiali:  
dërrasa e zezë e përgatitur;  
eventualisht kopje të fletës  
së punës «Penguesit e  
komunikimit».

Rrjedha:

- Para fillimit të mësimet M e ka shkruar në dërrasë të zezë një listë me frenuesit e komunikimit (shih nocionet e shkruara me shkronja të trasha në fletën e punës më poshtë).
- Lista do të shikohet dhe komentohet me klasën. N duhet të gjejë një titull. Nëse asgjë e përshtatshme nuk gjendet, M propozon titullin «Frenuesit e komunikimit». Disa pika, ndoshta do të shikohen përsëri, veç e veç, nën aspektin se si secili prej tyre mund të bllokoi një bisedë apo një situatë tjerë të komunikimit. Sigurisht se N mund të plotësojnë me shembuj nga përvoja e tyre personale.
- Në një lojë rolesh duhet të përjetohet duke konkretizuar se çfarë ndikimi mund të kenë mënyrat e sjelljeve të lartpërmendura. Është e nevojshme për dy role: dikush (Roli A) i cili dëshiron që të ketë një bisedë normale (p.sh. në lidhje me shkollën apo aktivitetet e lira), dhe dikush (Roli B) që e pengon komunikimin në mënyrë të përsëritur nëpërmjet pengesave të komunikimit, si ndërprerjes, pyetjeve të papërshtatshme etj. Në një raund të parë, M mund të marrë rolin e A, nëse nuk ka rrezik që N ta keqkuptojnë këtë.
- Luajtja e roleve kufizohet në 5 minuta. Roli A do të dominojë bisedën dhe ta shpjerë deri në përplasje; Roli B provon, në mënyrë të përsëritur, ta vazhdojë në partneritet bisedën. .
- Diskutimi i shkurtër/reflektimi/analiza; pastaj 2–3 raunde shtesë me N të tjerë.
- Reflektim përfundimtar: Si janë ndjerë N në rolin e tyre B? Po ata në rolin e tyre A? A ka sipas jush ndonjë model të komunikimit ose frenimit, që janë tipike për një kulturë, një grup gjinie apo moshe? Çfarë strategjish përdorni ju personalisht në situatat kur dikush përpiqet për ta sabotuar komunikimin?
- Për thellim ndoshta dhënia për lexim e fletës së punës «Penguesit e komunikimit».

Penguesit e komunikimit	Kështu bëhet (më mirë jo kështu!)
<p><b>Ndërprerja:</b></p> <p>ndërprerjet janë ndoshta arsyeja më e shpeshtë pse një komunikim mund të pengohet. Ato përcjellin ndjenjën e drojtjes se personi tjetër nuk e dëgjon fare dhe nuk e merr tjetrin seriozisht.</p>	<p>Lëshon shprehje në mënyrë të përsëritur gjatë kohës kur bashkëbiseduesi yt flet – p.sh. me komente për veten dhe gjërat që ke përjetuar.</p>
<p><b>Dhënia e këshillave të pakërkuara:</b></p> <p>Askush nuk do të marrë këshilla të pakërkuara. Deklarata të tilla si: «Në qoftë se unë do të isha vendin tënd ...» apo «Nëse ti më pyet mua ...» janë shpesh një shami e kuqe. Ato thonë: «Unë jam më superior ndaj teje». Këshillat e pakërkuara mund të shkaktojnë atë që bashkëbiseduesi juaj të ndjehet i pafuqishëm dhe i pazoti..</p>	<p>Jep shumë këshilla të pakërkuara. Të padurueshme janë thëniet, si: «Në qoftë se do të isha në vendin tënd ...», «Unë mendoj se ti duhet të ...», «Më mirë bëje kështu ...», «Nëse më pyet mua ...» etj.</p>
<p><b>Vlerësimi:</b></p> <p>Në qoftë se ti i sqaron bashkëbiseduesit tënd se idetë apo ndjenjat e tij janë të gabuara, ti e krijon përshtypjen se ti i di më mirë. Kjo shpesh çon në vetëmbrojtje ose në lëndime. Është më mirë në qoftë se ti e formulon një vlerësim sipas këndvështrimit tënd personal.</p>	<p>Vlerësoje bashkëbiseduesin tënd dhe çdo gjë që ai/ajo thotë. Mjetet për këtë: «Shumë më mirë do të ishte ...», «Ky është objektivisht një absurditet ...» «Kështu sigurisht nuk shkon...» etj.</p>
<p><b>Interpretimi:</b></p> <p>Kush i interpreton dhe i analizon vazhdimisht deklaratat e bashkëbiseduesit të tij jep përshtypjen se i di më mirë dhe nuk e merr seriozisht bashkëbiseduesin e tij, ashtu siç është.</p>	<p>Analizo çdo gjë që bashkëbiseduesi yt thotë. Për shembull, kështu: «Ti mendon se është kështu. por gaboresh ....» «Ti thjesht nuk e di se si të merresh me të» etj.</p>
<p><b>Dominimi:</b></p> <p>Të bisedosh me dikë që di gjithnjë më mirë ose tregon në mënyrë më interesante, është demotivuese. Bashkëbiseduesi së shpejti ose do të tërheqet prapa i tëhuajësuar ose do të reagojë me ashpërsi.</p>	<p>Përqëndroje bisedën gjithnjë nga vetja dhe bëje të qartë se ti e di më mirë: «Jo, kjo është kështu e ashtu ...», «Unë kam përjetuar diçka shumë më emocionuese».</p>
<p><b>Të shtrohen pyetje të pamatura:</b></p> <p>Kush shtron vazhdimisht pyetje, në vend se një herë të dëgjojë me vëmendje, e shtyn bashkëbiseduesin në mbrojtje. Nëse ti pyet shumë, ti e shpërqendron bashkëbiseduesin tënd dhe jep përshtypjen e mosbesimit dhe të kontrollit.</p>	<p>Vendose një ton sfidues në pyetjen: «Pse ke shkuar atje?» «Cilin ke takuar», «Çfarë do të thotë kjo vallë?», etj.</p>
<p><b>Ta vësh në pikëpyetje, ta fajësosh, të ndërhysh:</b></p> <p>Kush vë në pikëpyetje gjithçka që thotë bashkëbiseduesi, kush i përmbys vazhdimisht idetë e bashkëbiseduesit, e pamundëson komunikimin në partneritet e të barabartë.</p>	<p>Ndërhyj vazhdimisht dhe thuaj bashkëbiseduesit tënd se e ka gabim: «Ti s'ke të drejtë», «Kjo nuk mund të jetë fare kështu» etj.</p>
<p><b>Të kritikosh, të fyesh, të poshtërosh:</b></p> <p>Komentet negative, ironike, cinike ose sarkastike krijojnë përshtypjen sikur ti di më mirë, bëhen demotivuese. Vështirë se dikush dëshiron ta vazhdojë një bisedë, në të cilën ai/ajo fyhet dhe thyhet.</p>	<p>Bëj vërejtje sarkastike negative si: «Ti e mendon veten se je shumë i zgjuar», «Ti kurrë nuk ke pasur intuitë të mirë për njerëzit» etj.</p>



**Njësia 5:  
Konfliktet – të kërkojnë  
bashkërisht zgjidhjet**



Mësimi, në përgjithësi, dhe mësimi në gjuhën e prejardhjes, në veçanti, kanë për qëllim që t'i integrojnë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, me tregimet, ndikimet, parakushtet dhe vetitë individuale të tyre në një realitet të përbashkët në kuadër të klasës dhe të shkollës. Është e vlefshme të zhvillohen rregullat dhe mënyrat e të sjellurit që çojnë bashkërisht në bashkëpunime të frytshme. Mësimi dhe M i takon detyra për t'i perceptuar konfliktet e shfaqura dhe për t'i tematizuar në atë mënyrë që të gjenden mundësitë e të sjellurit në përshtatje me zgjidhjen e mundshme të problemeve.

Konfliktet ndodhin në jetën e përbashkët të përditshme në shkollë në mënyrë të pashmangshme. Kjo ndodh sa herë që interesat e individëve apo të grupeve janë në kundërshtim me interesat e individëve apo grupeve të tjerë. Arsyet mund të jenë mospërputhjet në bashkëpunim apo edhe paragjykimet dhe mendimet, të cilat përplasen me njëra-tjetrën.

Krahasuar me klasat e rregullta multikulturore, grupet e MGJP kanë veçorinë se janë homogjene në aspektin gjuhësor dhe të kulturës së prejardhjes. Por, edhe në MGJP fjala është për të parë komunitetin shumëkulturore dhe shoqërinë e vendit mikpritës si një realitet dhe një gjë të natyrshme. Vetëm kështu konfliktet e shfaqura mund të zgjidhen brenda kuadrit të një qasjeje reflektuese dhe të arsyeshme. Çdo nxënës/e i takon një grupi të caktuar etnik, por është, para së gjithash, edhe pjesë e një grupi tjetër më të madh.

Prandaj, zgjidhja e konflikteve nuk duhet të orientohet sipas përkatësisë së një grupi etnik, por në përkatësinë reale të një bashkësie shoqërore të vërtetë multikulturore. Për ngritjen e kompetencës ndërkulturore, për të cilën bëhet fjalë këtu, edhe MGJP mund të japë një ndihmesë të rëndësishme.

Ndër detyrat e mësuesit është që konflikteve t'u kushtojë vëmendje dhe që nxënësit/et t'i shkollojë në kompetencën e tyre perceptuese, reflektuese dhe vepruese. Qëllimi për këtë është që të gjenden dhe të provohen strategjitë e menaxhimit të konflikteve dhe zgjidhjet, të cilat janë të rëndësishme për bashkëpunimin dhe shëndetin mendor të të gjithë atyre që janë të përfshirë. Natyrisht, zgjidhjet e tilla të konflikteve nuk duhet të krijojnë tëhuajësime të reja, nuk duhet të betonojnë stereotipet, nuk duhet t'i thellojnë ndarjet ndërmjet palëve në konflikt. Këtu nuk është fjala vetëm për harmoninë aktuale në klasë. Shumë më tepër këto përmbajtje mësimore mund të shihen si përgatitje shumë e mirë për jetën në shoqëri.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj teme, një bashkëpunim mes mësuesve të MGJP dhe të atyre të klasëve të rregullta do të ishte këtu veçanërisht për t'u përshëndetur. Nëntë propozimet mësimore në vijim tregojnë, se si nxënësit/et në nivele të ndryshme e në fushat e pjesshme të kompetencës së perceptimit, reflektimit dhe veprimit mund të punojnë në kompetencën e tyre sociale dhe atë të zgjidhjes së konfliktit. Për kompetencat e pjesshme në të cilat është përqendruar kjo njësi, gjendet një pasqyrë në fund të broshurës.

Propozimet për klasat dhe nivelet janë shumë të gjera dhe duhet të kuptohen si këshilla, të cilat edhe mund të modifikohen. Gjëja më e rëndësishme këtu është roli i mësimitdhënësit, i cili tek formimi i këtyre kompetencave të përmendura, pikëpamjeve dhe mënyrës së sjelljes edhe një herë, është më shumë se vetëm një ndërmjetës, trajner dhe shoqëruar i kujdeshëm dhe i vëmendshëm i proceseve të të mësuarit dhe të sjellurit.

# 5.1 Gjithçka në rregull! Vërtet?

## Qëllimi

N zhvillojnë mirëkuptimin për konfliktet në klasën e tyre dhe për bashkëjetesën në shkollë. Ata bëjnë një renditje të parë dhe i kategorizojnë konfliktet në llojet e ndryshme të tyre.

kl. 1-9



30-45 min.



Materiali:  
flipchart, dy fletë të mëdha (A2),  
shirita letre.

Rrjedha:

- M shkruan titullin «Çdo gjë në rregull! Vërtet?» në dërrasën e zezë ose në një flipchart-letër. N mendohen për gjërat, që nuk janë në rregull në grupin ose klasën e tyre. Është e rëndësishme që M së pari tregon për format e ndryshme të vështirësive:
  - Problemet e bashkëpunimit me N tjerë.
  - Problemet në mes vajzave dhe djemve.
  - Problemet në ndarjen e gjërave (p.sh. ndarja e vendit të punës ose e materialeve).
  - Problemet në miqësinë me të tjerët.
- N i shkruajnë problemet dhe konfliktet e tyre në shirita të vegjël prej letre dhe i ngjitin ata në mënyrë të pavarur në tabelë ose flipchart. Kur të gjithë shiritat e letrës të jenë ngjitur, N ulen në një rreth.
- Pastaj M shpjegon se ka dy lloje konfliktesh dhe problemesh: individuale dhe kolektive. Kjo do të ilustruhet nëpërmjet shembujve (shumë zhurmë në klasë = problem i zakonshëm, shumë pak hapësirë në tavolinë = problem individual etj). Pastaj shiritat e letrës do të shqyrtohen dhe do të ndahen në dy kategori. Për këtë qëllim M ka përgatitur dy fletë të mëdha me titujt «problemet e përbashkëta» dhe «problemet personale». Kur të gjitha problemet të jenë kategorizuar do të zhvillohet një bisedë më tërë klasën rreth pyetjes «Cilat probleme mund të zgjidhen thjesht, si mund të duket kjo?». Sekuenca përfundon me një koleksion të problemeve të thjeshta të zgjidhshme.

Problemet e përbashkëta: 	Problemet personale: 
<p>Ne kemi shumë detyra shtëpie.</p>	<p>Agimi i merr gjithnjë ngjyrat e mia pa më pyetur.</p>
<p>Kemi pak kohë për provime.</p>	<p>Unë përqeshem shkaku i flokëve të mia të kuqe.</p>
<p>Djemtë nuk na lejojnë të luajmë futboll me ta.</p>	

# 5.2 Jo-ja ime

## Qëllimi

*N identifikojnë se zgjidhja gojore e konfliktit dhe respektimi i rregullave janë strategji të suksesshme për trajtimin e konflikteve. Ata ushtrohen në bazë të situatave të përditshme sipas moshave që kanë «Të grindurit përnjëmend» (kompetenca e komunikimit).*

kl. 1–3

30 min.




Materiali:

Asnjë, ose në varësi të situatës së lojës.

Rrjedha:

- M e mendon një situatë tipike të konfliktit dhe e shpjegon atë. Më pas, situata do të luhet dy-tri herë në formën e një loje rolesh. Shembull: Një fëmijë ndërton një kullë me blloqe. Një tjetër fëmijë hyn dhe e ngacmon atë, duke e shtyrë dhe penguar fëmijën e parë. Fëmija i parë reagon, ia bën të qartë fëmijës përballë kërkesat e tij, duke u shprehur si vijon: «Ndal, unë dua të luaj vetëm» ose «Unë nuk dua që ti të më zemërosh». Fëmijët duhet t'i shprehin këto nevoja me zë të fortë dhe vendosmëri të plotë.
- Në bazë të kësaj situatë të lojës, N ndikohen të bëjnë formulime të qarta për të shprehur nevojat e veta. Fëmijët mund t'i risjellin më vonë nga kujtesa këto formulime në situata reale dhe janë në gjendje të shprehin, pa keqkuptime, nevojat e veta në mënyrë të qartë.



- Situata të tjera të lojërave ose të të mësuarit mund të jenë si p.sh: ndërhyrje gjatë vendosjes bashkë të rebusëve, situata problemesh në dhomën e veshjes (dikujt i është marrë diçka, ose një fëmijë nuk ka vend), konfliktet gjatë punës në këndin e modelimit etj.
- Pas ngurrimit fillestar, N janë zakonisht mjaft të gjallë. Loja shërben, në njërën anë, për t'i luajtur situatat pa stërmundim dhe për të praktikuar sjelljen e duhur në situata të ndryshme. Nga ana tjetër, ajo gjithashtu mund të ndihmojë për t'i çliruar emocionet e ndryra.

## 5.3 Arsyje të mira për veprime të këqija?

### Qëllimi

*N në bazë të skenarëve të shkurtër zbulojnë prapaskenat e mundshme të sjelljes konfliktuale. Ata zhvillojnë të kuptuarit se çfarë ndjenjash dhe dëshirash mund të çojnë në një sjellje të qartë negative. Në këtë proces ata ushtrojnë kompetencën e tyre të perceptimit dhe të reflektimit.*

kl. 4–9

30–45 min.



Materiali:

Përshkrimet e shkurtra të situatës (M duhet paraprakisht të mendohet për disa situata).

Rrjedha:

- N ulen së bashku në grupe treshe ose katërshe. Çdo grup merr një ose dy përshkrime të shkurtra të situatave në të cilat një person është duke bërë diçka të keqe. (Shembull: një fëmijë kërcënon një tjetër me rrahje, në qoftë se ai nuk do t'i japë atij paratë që ka në xhep.) Është e rëndësishme që situata t'i përshtatet moshës dhe t'i përgjigjet botës së fëmijëve. Tani grupi i vogël diskuton rreth asaj se cilat mund të jenë motivet dhe arsyet për sjelljen negative. Çfarë ndjenjash dhe dëshirash mund të fshihen pas kësaj? Përgjigjet dokumentohen me shkrim në grupin e vogël.
- Pastaj secili grup paraqet para klasës rastin e tij dhe motivet e mundshme, që sipas mendimit të tyre, qëndrojnë prapa sjelljes negative.
- Pyetjet e mundshme- shtesë dhe nxitjet për një diskutim përfundimtar në grup, ose me tërë klasën:
  - A keni pasur edhe ju ndjenja apo dëshira të tilla?
  - Çfarë bëni, kur keni ndjenja të tilla?
  - A njihni njerëz, që sillen kështu?

## 5.4 Kështu e bëjmë ne këtë!

### Qëllimi

*N mendohen në lidhje me strategjitë e tyre të zgjidhjes së konfliktit (Kompetenca e reflektimit). Ata zhvillojnë mirëkuptimin për aspektet e ndryshme, personalitetet e ndryshme dhe sjelljet e ndryshme. Ata i pasqyrojnë strategjitë e tyre të parapëlqyera dhe strategjitë e praktikuara zakonisht për zgjidhjen e konflikteve.*

kl. 1–9

30 min.



Materiali:

lista ose fletë me konflikte të ndryshme (të përgatitura nga M), flipchart ose poster.

Rrjedha:

- N do të ndahen në grupe treshe apo katërshe. M paraqet në fletë apo lista një numër problemesh apo konfliktesh të mundshme (krahaso edhe këtë sekuencë 5.1; mund të bëhet fjalë për konflikte individuale, por edhe për probleme ose konflikte të përbashkëta). Secili grup përzgjedh dy konflikte, të cilat duan t'i përpunojnë së bashku (në rast të kohës së shkurtër në shfrytëzim: vetëm një konflikt).
- Më pas, grupet diskutojnë idetë për zgjidhjet e mundshme të dy konflikteve, që i kanë përzgjedhur vetë. N shënojnë me shkrim ose me vizatim idetë e tyre dhe modelojnë një poster për zgjidhjet e ndryshme, të mundshme. Zgjidhjen e atij konflikti që ata si grup e parapëlqejnë, e nënvizojnë ose dallojnë me ngjyrë.
- Njësia përfundon me prezantimin dhe diskutimin e të gjitha propozimeve të zgjidhjes së konflikteve para klasës.

# 5.5 Të ruhet gjakftohtësia ose i mençuri lëshon/largohet

## Qëllimi

Në përputhje me moton «Unë nuk do të lejoj të më provokojnë» N nëpërmjet luajtjes së roleve të vogla, mësojnë të mos përfshihen në konflikte. Ata ushtrojnë në një hap të dytë, t'u shmangen konflikteve ose situatave provokuese, në përputhje me moton: «Unë nuk duhet t'i nënshtrohem asnjë grindjeje, unë mund të largohem» (kompetenca e komunikimit).

kl. 1–6

45 min.



Materiali:  
dërrasa e zezë ose poster.

Rrjedha:

- M i lë N të tregojnë për situatat e grindjeve. N emërtojnë pastaj mundësitë e ndryshme se si ata mund t'u shmangen provokimeve dhe «ofertave për grindje» dhe cilat strategji të tjera, ndoshta, do të ishin të mundshme. M i shënon opsionet në fletë letre ose në një poster (me shkrim ose me vizatime).
- Tani M i zgjedh ato përgjigje, që i përshtaten strategjisë «qëndrojmë të qetë» dhe lejon që këto zgjidhje të paraqiten edhe në formë skenike (si lojë rolesh). Çdo herë duhet të bëhen këto katër gjestet e mëposhtme: të kryqëzohen krahët, të ngrihen lart shpatullat, të bëhet «Phh» dhe të kthehet. Të gjithë N e luajnë këtë me një partner. M i shënon në tabelë ose në poster: «Qëndro gjakftohtë – ktheja shpinën!».



- Në një hap të dytë, M do të pyetë se në cilat situata nuk është e mjaftueshme një shpërfillje si ajo e paraqitur më lart. Ai pastaj, nga shënimet e zgjidhjeve të konflikteve, i zgjedh përgjigjet që i përshtaten strategjisë «i mençuri largohet». Përsëri këtu inskenohet luajtja e roleve të vogla dhe diskutohen. Për në shtëpi të gjithë N marrin për detyrë, t'i provojnë konkretisht të dy këshillat. Në njësinë pasuese do të shkëmbehen dhe do të diskutohen përvojat përkatëse.

# 5.6 Termometri im i konfliktit

## Qëllimi

N perceptojnë dhe e identifikojnë se për çfarë lloj konfliktesh ata janë veçanërisht të ndjeshëm. Krahasuar me të tjerët ata e kuptojnë se konfliktet përjetohej dhe perceptohen subjektivisht. Kjo nuk ka të bëjë me atë se a është mirë apo keq, por se si dikush përjeton diçka.

kl. 4–9

30–45 min.



Materiali:  
Kartat me të dhënat e temperaturës (0°, 50°, 100°), situatat për t'i lexuar (shih më poshtë).

Rrjedha:

- M shpjegon se për çfarë po bëhet fjalë (shih më lart) dhe i vendos të tri fletët e temperaturës në formën e një termometri në dysheme. 100° do të thotë se është një konflikt i nxehtë. 50° do të thotë se bëhet fjalë për një konflikt, por i cili ndoshta nuk është edhe aq i rëndësishëm. 0° simbolizon se situata në fjalë nuk përjetohet si konflikt.
- Pastaj M i lexon fletët me situatat e ndryshme konfliktuale. N e vendosin secilën herë në atë pozitë në termometër, e cila përputhet me vlerësimin subjektiv të ashpërsisë së konfliktit. Nëpërmjet deklaratave të shkurtra ata arsyetojnë se pse e kanë zgjedhur atë pozitë. Këto deklarata nuk duhet të komentohen; është fjala për paraqitjen e pikëpamjeve individuale se si e përjeton konfliktin secili/a.
- Në përfundim do të diskutohet dhe do të sqarohet nocioni «konflikt». Nëse është e mundur, bëhet një përkufizim i përbashkët i nocionit dhe mbahet shënim për këtë.

### Shtesë: Situatat për lexim para të tjerëve dhe fletët e temperaturave

Një nxënës ia vë stërkëmbësën nxënësit tjetër në oborrin e shkollës.	Një nxënës e fyer një nxënëse tjetër me fjalën «kurvë».	100°
Një nxënës e kërcënon me rrahje nxënësin tjetër, sepse ai nuk ia jep atij xhaketën e vet.	Një shok të ka marrë hua të holla.	50°
Një nxënëse bën një listë se cilët shokë/qe i do më shumë.	Një nxënëse i thotë një nxënësi «ty të vjen erë e keq»	0°
Një nxënëse e merr celularin e shoqes së bankës, pa e pyetur atë dhe luan me të.	Një nxënës e rrëzon përtokë një nxënës tjetër, për të mënjeluar që ai të godasë një nxënës më të ri.	
Ti dëshiron me qejf të luash një lojë. Por shoku yt më me dëshirë do të lexojë një libër.	Dy nxënës diskutojnë për një mësuese.	



# 5.7 Në 6 hapa të zgjidhet problemi/konfliktet e bashkëmoshatarëve

## Qëllimi

*N njohin një teknikë për të zgjidhur konfliktet. Ata e kuptojnë se zgjidhja e konflikteve është e lidhur edhe me shkathhtësi dhe aftësi, të cilat mund të mësohen.*

kl. 6–9

60 min.



Materiali:  
Fleta e punës «Në 6 hapa të zgjidhet problemi».

Rrjedha:

- M përshkruan një situatë reale të konfliktit (shih shembujt më poshtë). Situata do të luhet në formë të një loje rolesh. N diskutojnë bashkërisht se si mund të zgjidhet konflikti. Është e mundur që ata të përshkruajnë tashmë pjesë të hapave të modelit «Në 6 hapa të zgjidhet problemi».
- N marrin fletën e punës «Në 6 hapa të zgjidhet problemi». Pasi ta kenë lexuar, do të përmbledhen shembuj të konflikteve, që ndodhin mes prindërve dhe fëmijëve, ose brenda grupit të bashkëmoshatarëve. Shembuj:
  - Vajza/djali dëshiron të shkojë në një lokal të caktuar, kurse prindërit thonë se është më të mirë që fëmija të mësojë dhe të mos shkojë pikërisht në atë lokal.
  - Një nxënës tallet me një nxënës për shkak të theksit të tij ose për shkak të një gabimi gjuhësor.
  - Vajza/djali njoftohet me një djalë/vajzë, por prindërit nuk e pëlqejnë për shkak të origjinës së tij ose të saj (për shembull, për shkak se ai/ajo i përket një kombi apo grupi etnik tjetër).
  - Disa të rinj duan të dëgjojnë një muzikë të caktuar gjatë pushimit. Të tjerët janë kundër, sepse ata parapëlqejnë të dëgjojnë një muzikë tjetër.
  - Disa N refuzojnë të ulen pranë një nxënësi të caktuar/nxënëseje të caktuar për shkak se ata kanë paragjykime në lidhje me prejardhjen, besimin fetar ose kombësinë e tij/e saj.
- Do të zgjidhet një konflikt, i cili pastaj do të analizohet deri në hollësiira (Variante: 2–3 konflikte për 2–3 grupe).
- Në një hap të parë, palët në konflikt ulen ndaras dhe i diskutojnë pozitativat e tyre, në bazë të planit 6-hapësh (p.sh. të gjithë «prindërit», të gjithë të rinjtë që duan të dëgjojnë muzikë të caktuar, të gjitha vajzat/të gjithë djemtë, që nuk duan të ulen në atë vend etj.). Pastaj takohen me palën tjetër brenda grupit të tyre dhe fillojnë «negociatat» sipas planit 6-hapësh. Pas një kohe të caktuar (15–20 minuta), M do t'i ndërpresë ato dhe i sjell N përsëri në klasë. I gjithë grupi i shkëmben përvojat e tyre.
- Shënim: Do të ishte ideale nëse do të caktoheshin ndërmjetësuesit/et të cilët do ta shoqërojnë nga një grup dhe do ta udhëheqin nëpërmjet planit 6-hapësh. Kjo gjithashtu mund të vazhdohet edhe në një raund të dytë.

Kopiervorlage Arbeitsblatt «In 6 Schritten das Problem lösen» → siehe nächste Seite.

# Në 6 hapa të zgjidhet problemi

Fletë pune për nxënësit/et

<b>Hapi 1: Të sqarohen nevojat.</b>	
Çka ke nevojë ti? Çfarë dëshiron saktësisht ti?	<i>Secili person i përfshirë në konflikt do të duhej t'i përgjigjet kësaj pyetjeje, pa i fajësuar të tjerët ose pa iu bërë atyre vërejtje.</i>
<b>Hapi 2: Përshkruaje problemin saktësisht.</b>	
Në këtë rast cili është problemi sipas mendimit tënd?	<i>Të gjithë nxënësit/et mund ta përshkruajnë problemin dhe shkaqet nga këndvështrimi i tyre. Kundërshtarët në konflikt duhet të jenë të gatshëm t'i pranojnë këndvështrimet e grupeve të tjera.</i>
<b>Hapi 3: Kërko pas zgjidhjeve të ndryshme.</b>	
Si mund të duken zgjidhjet e mundshme për këtë konflikt?	<i>Të gjithë nxënësit/et mund të ndihmojnë me përgjigjet e tyre. Këto do të duhej të shkruhen – pa komentim ose arsyetim. Qëllimi është që të gjenden sa më shumë zgjidhje.</i>
<b>Hapi 4: Vlerësoji zgjidhjet.</b>	
Sa do të ishte i kënaqur me zgjidhjet e ndryshme?	<i>Secila palë në konflikt i vlerëson propozimet për zgjidhje dhe sqaron se cilat dhe pse janë të pranueshme dhe cilat janë të papranueshme dhe pse.</i>
<b>Hapi 5: Vendos cila është zgjidhja më e mirë.</b>	
A e pranon këtë zgjidhje? A do të zgjidhej problemi?	<i>Duhet të jetë e qartë që të dy palët në konflikt ta pranojnë zgjidhjen. Përpyekjet e tyre për të gjetur një zgjidhje duhet të çmohen.</i>
<b>Hapi 6: Hulumto se si mund të zbatohet zgjidhja.</b>	
Lejonani të flasim edhe një herë mbi situatën dhe të sigurohemi se problemi u zgjidh.	<i>Një plan do të zhvillohet për ta evaluuar zgjidhjen. Varësisht nga forma e konfliktit dhe moshës së palëve në konflikt mund të zhvillohet një rivlerësim për disa minuta, orë ose në një leksion tjetër.</i>

**Njësia 6:**  
**Demokracia dhe të drejtat**  
**e fëmijëve: Ne përzihemi**



Zhvillimi i shoqërive moderne shtron një pyetje të rëndësishme. Ajo ka të bëjë me faktin se e drejta për liri e mbështet automatikisht edhe zhvillimin e shoqërive laike, pluraliste dhe të hapura. Ky zhvillim përkrah një jetesë gjithnjë e më shumë të individualizuar. Pyetja: Si munden këto shoqëri pluraliste, në raport me vlerat thelbësore, megjithatë të gjejnë një marrëveshje minimale, e cila të jetë e detyrueshme për të gjithë qytetarët/et? Nëse mundon pra një marrëveshje a konsensus i tillë, shoqëria përbëhet vetëm nga individë pa marrëveshje të detyrueshme dhe rrezikohet të bjerë.

Themelet e demokracisë, si dhe të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve, janë të pranuar dhe të vlefshme pothuajse në të gjitha shtetet. Ato ndihmojnë që qytetarët/et të diskutojnë mes tyre. Përveç kësaj, ato kanë ndihmuar në masë të madhe në modernizimin e sistemeve politike, ekonomike dhe kulturore në botë. Megjithatë, themelet e demokracisë dhe të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve nuk duhet të merren si të vetëkuptueshme. Çdo brez duhet të japë ndihmesën e vet për zhvillimin e tyre, duhet të negociojë rishtas dhe të angazhohet që këto parime të lidhura dhe me të drejtat, të respektohen edhe në të ardhmen.

Të drejtat e njeriut, mbi të cilat mbështeten të drejtat e fëmijëve, kanë një traditë të gjatë. Pararendës dhe paralele mund të gjenden në besimet fetare të mëdha botërore dhe në shumë rryma filozofike. Të drejtat moderne të njeriut u prezantuan për herë të parë gjatë kohës së Iluminizmit dhe frymëzuan revolucionin amerikan dhe francez. Në ditët e sotme ato janë të sanksionuara si ligje themelore në kushtetutat e shkruara (apo të pas-hkruara) të demokracive moderne. Që nga fillimi, të drejtat e njeriut ishin veçanërisht të rëndësishme për t'i mbrojtur anëtarët e dobët në shoqëri nga ata të fortit. Kjo është arsyeja pse të drejtat e fëmijëve janë aq të rëndësishme: të miturit janë në mesin e grupeve ku statusi i tyre ligjor ndaj pushtetit ekzekutiv është më i butë.

Modelet e mëposhtme mësimore u japin mësuesve dhe nxënësve mundësinë për të shkuar bashkërisht në rrugën drejt një demokracie të përjetuar në shkollë dhe t'i zbulojnë drejtpërdrejt të drejtat e fëmijëve.

---

Shënim:

modelet e mësimdhënies rrjedhin nga versioni në gjermanisht i përpunuar nga Gollob, Rolf; Peter Krapf; Wiltrud Weidinger (editors) (2008): Teaching democracy. A collection of models for democratic citizenship and human rights education. Council of Europe Publishing.

# 6.1 Një tufë lulesh

## Qëllimi

*Ky ushtrim nxit solidaritetin e grupit dhe ndjenjën e vetëvlerësimit të anëtarëve të tij. Ky ushtrim ua mundëson N të përjetojnë dhe ta çmojnë se çdo individ është i veçantë brenda një grupi, por në të njëjtën kohë ndihmon në forcën e përgjithshme të grupit.*

kl. 1-3

30-45 min.




Materiali:

Fotoportret i vogël i çdo nxënësi/eje (max 4x4 cm; eventualisht edhe vetëportret i vizatuar). Letër e verdhë ose ngjyrë portokalli, nga e cila priten qarqet me një diametër rreth 6 cm, të cilat përfaqësojnë brendinë e luleve. Letrat me ngjyra të ndryshme, nga të cilat priten petalet e luleve, lapsa me ngjyra të ndryshme, fletë të mëdha letre (A1, madhësia flipchart) ngjites.

Rrjedha:

- Çdo nxënës/e e merr një copë letre të rrumbullakët, në të cilën ai/ajo e ngjit portretin e vet.
- Çdo nxënës/e i merr gjashtë petale lulesh dhe shkruan në to një ose dy fjalë të mira për diçka:
  - Çfarë mund të thotë M rreth tij/saj (p.sh. «i zellshëm apo «sportiv»)
  - Çfarë mund të thotë një anëtar (mashkull) i familjes rreth tij/saj
  - Çfarë mund të thotë një anëtare (femër) e familjes rreth tij/saj
  - Çfarë thotë ai/ajo për vetveten
  - Çfarë mund tregojë një mik apo një mikeshë e tij/e saj për të
  - Çfarë mund të thotë dikush në klasë, në shkollë apo komunitet rreth tij/saj.
- Nxënësi/ nxënësjja i ngjet petalet e lules rreth rrethit me fotografi dhe e projekton në një formë të tillë lulëzimin.



- Lulet individuale do të sistemohen dhe ngjiten në një fletë të madhe letre.
- Për çdo kokë luleje, N vizatojnë një kërcell dhe gjethe, ashtu që të krijohet një tufë e larmishme. E pajisur me një nyjë, tufa e luleve duket veçanërisht shumë e bukur!
- Me tërë klasën; N ulen në rreth dhe e komentojnë tufën e tyre të luleve. Në këtë mënyrë atyre do t'u jetë bërë e kuptueshme rëndësia simbolike: tufa e luleve do të ishte më pak e pasur nëse ato lule do të mungonin nga ajo (bashkësia a jeta në komunitet); çdo lule është e ndryshme dhe ndihmon në mënyrë të veçantë për tufën (individualiteti, dinjiteti njerëzor); çdo lule/çdo portret është po aq i rëndësishëm sa edhe të tjerët (barazia).

# 6.2 Të gjithë të ndryshëm – të gjithë të njëjtë

## Qëllimi

*N e njohin dhe e akceptojnë më mirë njëri-tjetrin në një grup. Ata zbulojnë ngjashmëritë, për të cilat ata nuk ishin në dijeni më parë.*

kl. 2–6

30–45 min.



Materiali:  
një copë shkurtesë ose  
një pe i trashë.

Rrjedha:

- Hapësira e klasës (ose një pjesë e klasës pa tavolina) ndahet përmes një linje (me shkurtesë ose pe të trashë) në dy gjysma. E gjithë klasa në fillim qëndron në njërin anë të vijës.
- Tani, M numëron nga një seri karakteristikash (shih më poshtë) njërin mbi tjetrën. Sapo e emërtun një karakteristikë, e cila i takon ndonjërit prej fëmijëve, atëherë ata kalojnë në anën tjetër të vijës.
- Lista duhet natyrisht të hartohet sipas veçorive të moshës dhe në lidhje me situatën e klasës. Shembuj nga karakteristikat:

Ata, që ...

- sot kanë veshur xhinse;
  - e flasin ose e zotërojnë një dialekt të veçantë të gjuhës amtare;
  - janë më të rinj përkatësisht më të vjetër se sa mesatarja e ditëlindjes së të gjithëve;
  - kanë lindur në vendin e prejardhjes së prindërve të tyre;
  - kanë kaluar në këtë vend një pjesë të shkollimit të tyre;
  - rregullisht lexojnë ndonjë gazetë;
  - tashmë kanë qenë të ekspozuar ndaj diskriminimit;
  - kanë shokë/shoqe, të cilët janë me të meta fizike ose mendore;
  - kanë paragjykime në lidhje me një grup tjetër njerëzish.
- N diskutojnë pyetjet e mëposhtme:
    - A ka qenë dikush në ndonjë grup fëmijësh, me të cilin më parë besonte që nuk kishte asgjë të përbashkët?
    - Si ndjehesh të jesh pjesë e një grupi të madh?
    - Si ndjehesh të jesh vetëm ose pothuajse vetëm?
    - Ku keni bërë përvoja të ngjashme në jetën tuaj:
      - a) Përkatësia e një shumice,
      - b) ndjenja e të qenit vetëm dhe e mos-përkatësisë?

Zgjerim

Për një raund të dytë ose të tretë N mund të përpilojnë edhe vetë karakteristika të tilla. Por sa i përket pikave të ndjeshme ose diskriminuese, M duhet ta vë si kusht të drejtën e vetos.

# 6.3 Nëse do të isha një magjistar/ një magjistare

## Qëllimi

*N do të nxiten të zhvillojnë në mënyrë krijuese dhe imagjinative vizionet e tyre. Ata duhet të kuptojnë se njerëzit, që nuk kanë vizione, duhet të jenë të kënaqur përgjithmonë me status quo-në e tyre pasive.*

kl. 2-6

30 min.



Materiali:

Fillimet e parapërgatitura të fjalive të shënohen në dërrasë të zezë ose në flipchart (shih më poshtë), eventualisht të kopjohet si fletë pune.

Rrjedha:

- N duhet të vihet mendërisht në rolin e një magjistari /magjistareje. Sido-mos tek të rinjtë një akordim atraktiv dhe tërheqës është i rëndësishëm dhe nxitës.
- Ata lexojnë nga dërrasa e zezë ose flipchart fillimin e fjalisë «Nëse do të isha një magjistar i madh/magjistare e madhe, do të isha kujdesur që burrat, gratë dhe fëmijët kurrë më të mos e përjetojnë luftën. Për këtë ...
  - unë do të vendosja që ...
  - unë do të ndaloja që të ...
  - unë do të isha kujdesur që ...
  - unë do të ndalesha ...
  - unë do të vazhdoja ...
  - unë do të harroja ...
- N i plotësojnë me shkrim një ose më shumë nga këto fjali, në mënyrë individuale, ose në punën me partner.
- Një thjeshtësim krijohet nëse fillimet e fjalive (si dhe teksti fillestar) të jenë të përpiluara si fletë pune dhe u jepen N (natyrisht me hapësirë të mjaftueshme për t'i plotësuar përfundimet e fjalive). Me këtë, në të njëjtën kohë, mund të lidhet detyra që fleta të plotësohet përfundimisht në një sekuencë të mëvonshme ose si detyrë shtëpie.
- Në bashkësinë e klasës do të lexohen dhe do të diskutohen përgjigjet. Për këtë këshillohet që karriget të vendosen në formë rrethi. Nëse është e mundur, duhet të mbetet pakëz kohë për pyetje ose komente për ndihmesat individuale.
- Raundi përfundimtar/Përmbledhja: A ka elemente që janë emërtuar nga mjaft ose shumë N? Çfarë mund të bëjmë që disa «magji» ose vizione të lejojmë që të bëhen realitet?



Variante:

- «Nëse do të isha një arkitekt/e, unë do të ...»: N imagjinojnë se si shkolla e tyre ose qyteti i tyre mund ose duhet të duket.
- «Nëse unë do të isha i/e zgjedhur si politikan/e në mënyrë demokratike (varianti: kryetar i shtetit, ministre e drejtësisë etj), unë do të ...»



# 6.4 Udhëtimi i balonës

## Qëllimi

*N u bëhet e qartë rëndësia dhe universaliteti i të drejtave të njeriut. Ata e kuptojnë që disa të drejta nënkuptojnë edhe disa të drejta të tjera, por gjithashtu janë të domosdoshme. N u është e qartë se të drejtat e njeriut janë të pacenueshme dhe se nuk lejohet që ato të pezullohen në mënyrë arbitrare.*

kl. 4-6

45 min.




Materiali:  
stilolapsa dhe letër, fletë të mëdha të letrës;  
Lista e të drejtave të njeriut apo të fëmijëve (përzgjedhja shih më poshtë).

Udhëzime:

- Ky ushtrim mund të bëhet si një hyrje në një njësi mësimore mbi të drejtat e njeriut, ose në fund të një sekuence të tillë të bëhet një thellim në këtë temë.
- Peshat gjegjësisht balasti i balonës me ajër të nxehtë mund të bashkohen nga të drejtat e njeriut si më poshtë. Është gjithashtu e mundshme një tjetër përzgjedhje e të drejtave të njeriut, krahaso listën e plotë nga faqe të ndryshme në internet.

Rrjedha:

- N formojnë grupe pesëshe apo gjashtëshe. Secili grup do të marrë një pllakat dhe lapsa me ngjyra. N duhet të vizatojnë një balonë me ajër të nxehtë, që luhetet mbi det ose mbi një fushë (p.sh. mbi një vend ku është shkolla, ose mbi kryeqytetin e vendit të prejardhjes). Thasët e rërës, që e rëndojnë atë, simbolizojnë dhjetë të drejta të njeriut dhe do të ngjiten në pllakat (shih listën më poshtë).



- Tani mund të fillojë loja. N duhet të imagjinojnë se ata janë duke udhëtuar me një «balonë të të drejtave të njeriut». Balona fillon të bjerë dhe udhëtarët duhet të hedhin 2 deri në 3 thasë, për të parandaluar rrëzimin
- N do të caktojnë përparësitë për të drejtat e njeriut, të cilat simbolizohen nga thasët e rërës. Kriteret e mëposhtme janë vendimtare: A është një e drejtë e nënkuptuar te një e drejtë tjetër? A është ndonjë e drejtë e një rëndësie të veçantë për demokracinë, apo për nevojat tona personale?
- Megjithë përpjekjet, balona edhe më tutje rrezikohet të bjerë ,prandaj duhet që të hidhen një deri në dy thasë rëre, përkatësisht të drejta të njeriut. Pasi që janë hedhur nga bordi i balonës katër deri në pesë thasë rëre, balona ulet në tokë në mënyrë të sigurtë.

- Reflektim në klasë. Secili grup paraqet listën e vet dhe komenton disa nga përparësitë. Më pas listat mund të krahasohen. Çfarë dallimesh ka? Duhet të bëhet një bisedë-shtesë për punën në grupe. Ku është një marrëveshje veçanërisht e vështirë, pse? Ku qëndron vështirësia që disa të drejtave të caktuara t'u jepet përparësi ndaj disa të drejtave të tjera?
- Në një kushtetutë funksionuese, secila heqje e një të drejte do t'i bënte dëm të madh demokracisë. Të drejtat e njeriut janë të drejta natyrore dhe në këtë mënyrë të paprekshme. Në këtë drejtim udhëtimi i balonës ishte vetëm një simulim i një situatë, e cila shpresojmë se nuk do të ndodhë kurrë. Kjo duhet të bëhet e qartë përsëri në fund.
- Për ciklin e lartë kjo sekuencë mund të vazhdohet edhe më tutje, përpos asaj që do të hulumtohet se cilat të drejta gjenden në kushtetutën e vendit të prejardhjes ose të emigracionit dhe si mbrohen ato.

## Përzgjedhje e të drejtave të njeriut

→ E drejta për zgjedhje të lira
→ E drejta për pronë
→ Barazia midis burrave dhe grave /meshkujve dhe femrave
→ E drejta për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm
→ E drejta e qasjes në ushqim të shëndetshëm dhe ujë të pastër
→ E drejta për arsimim
→ E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë
→ E drejta për veshje dhe strehim për të gjithë qytetarët/et
→ E drejta për privatësi, në të cilën askush të mos përzihet
→ E drejta për lirinë e lëvizjes

# 6.5 Të drejtat, përgjegjësitë dhe rregullat në klasë

## Qëllimi

N njohin një metodë, nëpërmjet së cilës për rregullat mund të pajtohen në mënyrë demokratike, duke gjetur një gjuhë të përbashkët. Ata bëjnë një përvojë në drejtim të asaj se ndihmesa e tyre ka rëndësi dhe se ata kanë mundësinë e bashkëvendosjes. Ndjenja e vetëvlerësimit dhe pavarësia e tyre do të forcohet dhe ata e përjetojnë pjesëmarrjen aktive në bashkësinë e klasës.

kl. 4–6

45 min.



Materiali:

Letër e madhe e ndarë në tri fusha/ pjesë të barabarta (të paktën A3).

Rrjedha:

- Klasa ndahet në grupe me nga 4–5 N. Secili grup përcakton një zëdhënës/një zëdhënëse.
- Secilit grup i jepet një fletë letre (A2 ose A3), të cilën grupi e ndan në tri fusha/ pjesë. Në fushën e lartë N shkruajnë të drejtat, që sipas mendimit të tyre në një klasë duhet t'i kenë të gjithë N si dhe M. Çdo propozim do të pajiset me një numër.

Të drejtat:	Përgjegjësitë:	Rregullat:

- N ia kalojnë punën e tyre një grupi tjetër.
- Çdo grup ballafaqohen/përfaqen me listën e të drejtave të grupit të mëparshëm dhe mendohet të japë përgjigje në pyetjet e mëposhtme: Çfarë përgjegjësish apo detyrimesh kemi ne, në mënyrë që të drejtat në fushën e sipërme vërtet të respektohen? Çfarë duhet të bëjmë? Si duhet të sillemi?  
Shembull: «Secili/secila ka të drejtën për t'u dëgjuar» - «Pra, ne kemi përgjegjësi ose detyrim për të dëgjuar.»
- Në fushën e mesme ata shkruajnë përgjegjësitë apo detyrat e përshtatshme. Për këtë ata shkruajnë numrin nga fusha lart, me të cilin lidhet shënimi.
- M jep disa të dhëna: Përgjegjësitë kërkojnë rregullat. Kjo mund të ilustruhet tashmë me anë të rregullave të klasës ose të shkollës. Këto duhet të formulohen në mënyrë pozitive («Unë e bëj» në vend të «Unë nuk e bëj») ato duhet të jenë konkrete dhe të përshkruajnë sjelljen e dëshiruar.  
Për shembull të drejtën për t'u dëgjuar: ne kemi përgjegjësi për të dëgjuar; si rregull kjo kuptohet: mbaj qetësi, kur të tjerët flasin.
- N e përcjellin fletën e tyre më tutje. Grupet studiojnë të gjitha shënimet e të dy grupeve të mëparshme dhe bien dakord më pas për një sasi (më së shumti) prej pesë rregullave. Këto do të shkruhen në fushën e tretë të fletës.

- Në bashkësinë e klasës: Zëdhënësit/et e grupeve shpjegojnë përpara klasës rregullat e grupit të vet. Në vazhdim klasa diskuton nëse në një krahasim të tërthotë të listave veç e veç të grupeve, mjaft rregulla kryqëzohen ose përsëriten. Ata pajtohen në mënyrë demokratike, se çfarë duhet të fshihet ose të përmblihet.
- Votimi për rregullat. Secili/a nxënës/e merr katër gurë loje ose pika ngjitesë. Këto ai/a mund t'i japë për rregullat që, sipas mendimit të tij/ të saj, duhet të vlejnjë për klasën. N mund t'i japin gurët e lojës sipas dëshirës (të gjitha në një rregull të caktuar ose t'i shpërndajnë në 2, 3 ose 4 rregulla). Për klasën do të merren ato katër rregulla, të cilat kanë marrë më së shumti vota. Ato do të shkruhen në një poster, do të nënshkruhen nga të gjithë N dhe do të vendosen në një vend të dukshëm në klasë.

## 6.6 Posteri i të Drejtave të Njeriut

### Qëllimi

*N përqasen në mënyrë të thelluar me të drejtat individuale të njeriut dhe zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese.*

kl. 4–9

45 min.



Materiali:  
fletë të mëdha të letrës,  
lapsa me ngjyra, gërshërë,  
ngjites, gazeta të vjetra dhe revista,  
piktura dhe fotografi;  
Teksti i Konventës Evropiane për  
të Drejtat e Njeriut ose e Deklaratës  
Universale të të Drejtave të Njeriut  
(të dyjat gjenden në internet pa  
vështirësi).

Rrjedha:

- N formojnë grupe katërshe.
- M, ia cakton çdo grupi një artikull për të drejtat e njeriut (varianti: N mund të vendosin vetë se me cilin artikull dëshirojnë të merren).
- Çdo grup bën një poster për të drejtat e «veta» njerëzore. Posteri përmban elementet e mëposhtme:
- titullin, të cilin grupi e ka përzgjedhur për të Drejtat e njeriut.
- pjesën përkatëse të tekstit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.
- një imazh (simbol, simbol përmes vizatimit), i cili simbolizon të Drejtat përkatëse të njeriut (p.sh. një rrotë për lirinë e lëvizjes, një gojë ose buzët, për lirinë e shprehjen dhe fjalës).
- Për klasat më të larta: një analizë të strukturës së të drejtës përkatëse të njeriut me referencë:
  - Personat që kanë të drejtë për këtë të drejtë ose të cilëve kjo e drejtë u është veçanërisht e rëndësishme;
  - Përmbajtja e saj (çka mbron ose garanton ajo e drejtë);
  - Mjetet për zbatimin e saj përkatësisht realizimin e saj;
  - Eventualisht shembuj të shkeljes së kësaj të drejte.
- N paraqesin përpara klasës posterat e tyre dhe diskutojnë për ta.

# 6.7 Pakicat

## Qëllimi

*N u bëhet e qartë se ndjenja e përjashtimit, nuk është e lidhur vetëm me atë se si e shohin anëtarët e «jashtëm» të shoqërisë dikë, por gjithashtu ka të bëjë shumë me pranimin brenda grupit të tyre.*

kl. 7–9

45 min.



### Materiali:

Komplete të letrave pozitive dhe negative për secilin grup (shih më poshtë, duhet të prehen paraprakisht); Dy fletë të mëdha (A3 ose A2) për grup; në njërën qëndron fjala «ndjenjat», në tjetrën fjala «reagimet».

### Udhëzim:

Përmbajtja e sekuencës është në formë të një loje rolesh. Andaj N në fillim nuk duhet të dinë se cilin apo çfarë grupi ata do të përfaqësojnë, ngase është e mundshme të futen klisjetë në lojë.

Kushtet në lidhje me kohëzgjatjen dhe rregullat duhet të shpjegohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Në kuadër të këtyre kushteve N kanë shumë liri veprimi.

### Rrjedha:

- Klasa ndahet në grupe me nga katër nxënës.
- Secilit grup i jepet një komplet i letrave pozitive (shih më poshtë), një stilolaps dhe një fletë letre e madhe me titull «ndjenjat». Secili grup zgjedh dikë i cili komentet dhe reagimet e grupit i shënon në letër. (Alternativa: Çdo nxënës/e i shënon vetë deklaratat e veta.)
- M komunikon se N në ushtrimin vijues nuk do të përfaqësojnë veten, por anëtarët e një grupi të pakicave. Në një hap të parë, në bazë të letrave pozitive, ata duhet të mendohen se cilat janë pikat e forta dhe cilësitë e grupit të tyre dhe se si ndjehen si anëtarë të këtij grupi. Përgjigjet përkatëse do të diskutohen në grup dhe do të protokollohen te fleta «ndjenjat».
- Çdo grup merr tani një komplet me gjashtë letra negative dhe një fletë të titulluar «reagimet». Pyetja kryesore është kjo: Si do të sillleshit ju si anëtarë të grupit tuaj në bazë të përvojave të cilat janë të dokumentuara në letrat negative? Përgjigjet do të protokollohen në fletën «reagimet».
- Me tërë klasën:
  - Secili grup raporton për ndjenjat për të cilat ka shkruar në fletën «ndjenjat». Pyetjet e paqarta do të sqarohen, komentet do të diskutohen shkurtimisht.
  - Po ashtu do të vazhdohet me fletën «reagimet». Klasa duhet të identifikojë veprimet konstruktive, aktet e dhunës dhe t'i identifikojë dallimet në mes dhe brenda grupeve.
  - Raund për të punuar në grupe: Ku kishte probleme, pse; çfarë keni mësuar ju për veten dhe për të tjerët?
  - Pyetje/shtysa: A mund të krijoni një marrëdhënie në mes të grupit të pakicës të paraqitur prej jush dhe grupeve të tjera të cilat ju ndoshta i njihni?
- Raundi përfundimtar: Për cilin grup mund të bëhet fjalë sipas njerëzve të paraqitur në letra? (Zgjidhja: Është fjala për endacakët përkatësisht romët.)

**Materialet:  
Kompleti me letrat  
pozitive (majtas) dhe  
negative (djathtas)**

<p>Shtëpitë tona nuk janë si të njerëzve të tjerë. Ato janë speciale dhe ne i duam ato. Ne qëndrojmë fort në traditat tona.</p>	<p>Televizioni dhe shtypi nuk e thonë të vërtetën për ne. Ato thonë se ne jemi një problem. Ato nuk na japin hapësirë për të paraqitur pikëvështimin tonë.</p>
<p>Ne jemi shumë të shkathët dhe kemi shumë aftësi. Ne bëjmë punë të ndryshme zanati dhe dore. Ne japim me punën tonë ndihmesë të vlefshme për vendin në të cilin jetojmë.</p>	<p>Disa njerëz na trajtojnë keq dhe shkelin mbi ne. Ndonjëherë ne sulmohemi pa asnjë arsye. Mijëra prej nesh u vranë jo para shumë kohe më parë.</p>
<p>Populli ynë në të kaluarën ka bërë shumë veprime të guximshme. Ne e kujtojmë me dëshirë historinë tonë.</p>	<p>Ne nuk kemi gati fare ujë të pijshëm; mbeturinat tona nuk hiqen.</p>
<p>Ne jemi shumë të pavarur. Ne i shikojmë më me qejf vetë hallet tona. Nuk i kemi borxh askujt.</p>	<p>Mjaft mjekë nuk duan të na trajtojnë ne kur jemi të sëmurë. Është vështirë për ne për të marrë ndihmat sociale.</p>
<p>Ne mblidhemi me dëshirë bashkë për të treguar historira dhe për të kënduar. Ne mendojmë se është me rëndësi të forcojmë bashkësinë tonë. Familja (e madhe) për ne është institucioni ku mbështetemi.</p>	<p>Njerëzit nuk duan të na kenë afër tyre. Shumë njerëz nuk duan të na punësojnë, sepse ne i takojmë këtij grupi të popullit.</p>
<p>Ne mundohemi të jetojmë afër familjes dhe shokëve. Ne kujdesemi mirë për njerëzit në nevojë në bashkësinë tonë. Ne i duam fëmijët tanë mbi gjithçka. Nganjëherë kemi probleme me policinë dhe përgjegjësit vendorë, sepse ne duam të qëndrojmë në një vend të caktuar.</p>	<p>Nganjëherë kemi probleme me policinë dhe përgjegjësit vendorë, sepse ne duam të qëndrojmë në një vend të caktuar.</p>



*Ne mundohemi të jetojmë afër familjes dhe shokëve. Ne kujdesemi mirë për njerëzit në nevojë në bashkësinë tonë. Ne i duam fëmijët tanë mbi gjithçka. Nganjëherë kemi probleme me policinë dhe përgjegjësit vendorë, sepse ne duam të qëndrojmë në një vend të caktuar.*

# Vështrim mbi propozimet mësimore sipas fushave të kompetencave

## Propozime mësimore me fokus

### Kompetencën e përceptimit:

<b>1.1</b> Ky jam unë *	<b>1.3</b> Unë dhe të tjerët	
<b>2.1</b> Të shpërndarë nga era *	<b>2.4</b> Atdhetë e mi – tregime autobiografike *	<b>2.7a</b> Historia e migrimit e familjes sime **
<b>3.2</b> Projekte dy-ose shumëgjuhësore me shkrim **	<b>3.5</b> Dialektet në gjuhën tonë dhe në gjuhët e tjera *	
<b>4.3</b> Të dëgjuarit aktiv **		
<b>5.1</b> Gjithçka në rregull! Vërtet? **	<b>5.3</b> Arsye të mira për veprime të këqija? *	<b>5.6</b> Termometri im i konfliktit *
<b>6.1</b> Një tufë lulesh **	<b>6.4</b> Udhëtimi i balonës	<b>6.6</b> Posteri i të Drejtave të Njeriut *

## Propozime mësimore me qendër

### Kompetencën e reflektimit:

<b>1.2</b> Pamja e brendshme – pamja e jashtme *	<b>1.4</b> Më lejoni të fluturoj **	<b>1.6</b> Molekula personale e identitetit *
<b>2.2</b> Historitë e migrimit në klasën time **	<b>2.5</b> Më herët – sot – nesër	<b>2.7b</b> Shumëllojshmëria kulturore në lagjen tonë **
<b>3.1</b> Tiparet gjuhësore	<b>3.3</b> Tema biografike gjuhësore	<b>3.6</b> Korrespondenca për çështjet ndërkulturore
<b>4.1</b> Diçka nuk është në rregull këtu **	<b>4.4</b> Për vizitë *	<b>4.6</b> Atribuimet **
<b>5.4</b> Kështu e bëjmë ne këtë! **		
<b>6.2</b> Të gjithë të ndryshëm – të gjithë të njëjtë *	<b>6.7</b> Pakicat	

## Propozime mësimore me qendër

### Kompetencën e veprimit komunikues:

	<b>1.5</b> I pranuar – i përjashtuar	<b>1.7</b> Bashkërisht jemi të fortë
<b>2.3</b> Biografia ime e migrimit si burim force *	<b>2.6</b> Unë shkruaj historinë!	<b>2.7c</b> Emigrimi ka të bëjë me ne të gjithë **
<b>3.4</b> Përdorimi i mediave elektronike në gjuhë të ndryshme *	<b>3.7</b> Përdorimi i gjuhës: i ndryshëm, sipas kontekstit! *	
<b>4.2</b> Me gjuhë të tregohet rruga **	<b>4.4</b> Për vizitë *	<b>4.6</b> Atribuimet **
<b>5.4</b> Kështu e bëjmë ne këtë! **	<b>5.5</b> Të ruhet gjakftohtësia ose i mençuri lëshon/largohet *	<b>5.7</b> Në 6 hapa të zgjidhet problemi/ konfliktet e bashkëmoshatarëve **
<b>6.2</b> Të gjithë të ndryshëm – të gjithë të njëjtë *	<b>6.7</b> Pakicat	

Legjenda: \* = e përshtatshme / \*\* = shumë e përshtatshme për bashkëpunim me mësimin e rregullt.

# Literatura e përdorur

- Alle anders, alle gleich (1998): Education pack. Ideen, Quellen, Methoden und Aktivitäten für die informelle interkulturelle pädagogische Arbeit. Straßburg: Council of Europe.
- Auernheimer, Georg (2013): Interkulturelle Kompetenz und pädagogische Professionalität. Wiesbaden: Springer.
- Banka e të dhënave për shumë gjuhësinë në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Cyrihut: [http://www.phzh.ch/de/ipe/Projekte-und-Mandate/Europaweite-Projekte/Datenbank\\_Mehrsprachigkeit-EU-Projekt\\_Amuse/Datenbank-Mehrsprachigkeit/](http://www.phzh.ch/de/ipe/Projekte-und-Mandate/Europaweite-Projekte/Datenbank_Mehrsprachigkeit-EU-Projekt_Amuse/Datenbank-Mehrsprachigkeit/)
- Brander, Patricia et al. (2012): Compass. Manual for human rights education with young people. Straßburg: Council of Europe.
- Broschüre Kinderrechte: [https://www.stadt-zuerich.ch/ssd/de/index/volksschule/publikationen\\_broschueren/kinderrechte.html](https://www.stadt-zuerich.ch/ssd/de/index/volksschule/publikationen_broschueren/kinderrechte.html).
- Gudjons, Herbert; Birgit Wagener-Gudjons; Marianne Pieper (2008): Auf meinen Spuren. Übungen zur Biografiearbeit. Bad Heilbrunn: Klinkhardt.
- Gollob, Rolf; Peter Krapf; Wiltrud Weidinger (eds.) (2010): Growing up in democracy. Lesson plans for primary level on democratic citizenship and human rights. Straßburg: Council of Europe.
- Gollob, Rolf; Peter Krapf; Wiltrud Weidinger (eds.) (2008): Teaching democracy. A collection of models for democratic citizenship and human rights education. Straßburg: Council of Europe.
- Gollob, Rolf; Peter Krapf (eds.) (2007): Exploring Children's Rights. Nine short projects for primary level. Straßburg: Council of Europe.
- Gollob, Rolf et al. (2007): Politik und Demokratie – leben und lernen. Politische Bildung in der Schule. Grundlagen für die Aus- und Weiterbildung. Bern: Schulverlag.
- Heringer, Hans Jürgen (2012): Interkulturelle Kompetenz. Ein Arbeitsbuch mit interaktiver CD und Lösungsvorschlägen. Tübingen und Basel: A. Francke Verlag.
- Holzbrecher, Alfred (1999): Subjektorientierte Didaktik. Lernen als Suchprozess und Arbeit an Widerständen. Die Deutsche Schule. Zeitschrift für Erziehungswissenschaft, Bildungspolitik und pädagogische Praxis, 5. Beiheft, S. 141–168.
- Jennwein, Engelbert et al. (2011): Gefühle zeigen – Gewalt vermeiden. Soziales Lernen und konstruktive Konfliktbearbeitung. Donauwörth: Auer.
- Landesinstitut für Lehrerbildung und Schulentwicklung (LI): Trainingshandbuch Lernförderliche Gruppenentwicklung. Link: <http://li.hamburg.de/content/blob/3567428/data/download-pdf-trainingshandbuchlernfoerderliche-gruppenentwicklung.pdf>.
- Losche, Helga (2005): Interkulturelle Kommunikation. Sammlung praktischer Spiele und Übungen. Augsburg: ZIEL.
- Menschenrechte und Menschenrechtsbildung, Link: <http://www.humanrights.ch/> <http://www.phlu.ch/dienstleistung/zentrum-menschenrechtsbildung/>.
- Schader, Basil (2013): Sprachenvielfalt als Chance. Das Handbuch. Hintergründe und 101 praktische Vorschläge für den Unterricht in mehrsprachigen Klassen. Zürich: Orell Füssli Verlag.
- UNICEF, Praxisbuch Kinderrechte (2010): Eine Werkstatt für Kinder von 8 bis 12 Jahren. Link: [http://www.unicef.be/kids/IMG/pdf/praxis-buch\\_kinderrechte\\_komplett.pdf](http://www.unicef.be/kids/IMG/pdf/praxis-buch_kinderrechte_komplett.pdf).
- Website «Schule mehrsprachig» des österreichischen Bundesministeriums für Bildung und Frauen: <http://www.schule-mehrsprachig.at/>.
- Website e Projektit Marille: Mehrheitssprachenunterricht als Basis für plurilinguale Erziehung: <http://marille.ecml.at/Practiceexamples/Examples-frommajoritylanguageclassrooms/tabid/1847/language/de-DE/Default.aspx>.



**Vërejtje, përvoja, ide të tjera:**



Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejdardhjes (HSU)» përmbledh një radhë të vëllimeve, të cilat kontribuojnë në cilësinë e mëimit në gjuhën e prejdardhjes si edhe në lidhjen e saj të mirë me mësimin e rregullt.

Adresantët e kësaj serie janë mësuesit e ardhshëm dhe ata që praktikojnë MGJP-në, si edhe institucionet që përgjigjen për ta në vendet e prejdardhjes dhe të emigrimit.

Vëllimi i bazave (doracaku dhe libri i punës. Bazat dhe arsyet) transmetojnë ndër të tjera, pikat më të forta të pedagogjisë, didaktikës dhe metodikës aktuale në Evropën Perëndimore dhe Veriperëndimore.

Vëllimet me nxitje didaktike ofrojnë impulse konkrete dhe planifikime për sfera të ndryshme të mëimit (përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë etj) Të gjitha vëllimet lindën në bashkëpunim të ngushtë me mësues që praktikojnë MGJP-në, kështu që lidhja me praktikën dhe zbatueshmëria konkrete është bashkëmenduar që në krye.

Seria përfshin vëllimet e mëposhtme:



Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejdardhjes» botohet në gjermanisht, anglisht, shqip, në gjuhën boshnjake, kroate, serbe, portugalisht dhe turqisht. Ajo do të publikohet nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut.